



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-401/04-0012149/25
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	100	Data Datum Date	28.07.2025



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

ZYRA E KRYETARIT

Nr. _____. Data: 28/07/2025.

Mitrovicë Veriore.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2025

Mitrovicë Veriore, Korrik 2025

ZYRA E KRYETARIT

Si qeverisje lokale jemi te anagazhuar per qeverisje transparente, llogaridhenese dhe gjithmone duke pasur prioritet permiresimin e jetes se qytetareve pa dallim.

Ne raportin ne vijim prezantohen punet e drejtorive dhe njesive komunale ne detaje. Ku perfshihen sherbimet ne administrate, financa, kulture, rini dhe sport, infrastrukture, sherbime publike, inspektorat, shendetesi, mireqenie sociale, urbanizem, kadafter dhe gjeodezi, emergjencat si dhe te njesive tjera ne kuader te zyres se kryetarit.

Vlen te theksohet mbeshtetja financiare e ofruar qytetareve per qeshtjet shendetesore dhe sociale, ku deri me tani jane pagu 134,050.00 euro per 538 familje, ndersa shuma prej 19,450.00 euro per 60 familjet tjera pritet te procadohet gjate diteve ne vijim, ku si total jane 153,500.00 euro pagese si mbeshtetje financiare.

Ne nderkohe ne gjashte (6) mujorin e dyte te vitit do te procedohen pagesat per femijet e lindur ne vitin 2025 si dhe per qiftet e reja.

ZYRA E PROKURIMIT

Ky raport është përgatitur nga **Autoriteti Kontraktues - Komuna e Mitrovicës Veriore**, në përputhje me dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042**, i ndryshuar dhe plotësuar me **Ligjin Nr. 04/L-237**, **Ligjin Nr. 05/L-068** dhe **Ligjin Nr. 05/L-092**.

Raporti mbulon periudhën raportuese nga **01 janar 2025 deri më 30 qershor 2025**, dhe paraqet të dhëna të detajuara mbi aktivitetet e zhvilluara në fushën e prokurimit publik gjatë kësaj periudhe. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë transparencë, llogaridhënie dhe vlerësim të zbatimit të planit të prokurimit, përputhshmërinë me kornizën ligjore si dhe menaxhimin efikas të fondeve publike.

Përmes këtij dokumenti, Zyra e Prokurimit në Komunën e Mitrovicës Veriore synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi aktivitetet e realizuara në procesin e prokurimit, sfidat e hasura, si dhe masat e ndërmarra për përmirësim të mëtejshëm të performancës institucionale në këtë fushë.

Për më tepër, përmbajtja e raportit pasqyron një angazhim të vazhdueshëm për ndjekjen e praktikave më të mira në fushën e prokurimit, si dhe për zbatimin e procedurave të hapura dhe konkurruese, të cilat janë të domosdoshme për promovimin e një ambienti të drejtë dhe të besueshëm në përdorimin e burimeve publike.

I. Baza Ligjore dhe Rregullative

Procesi i prokurimit është zhvilluar duke respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Prokurimin Publik, duke siguruar:

- Transparencë në shpalljen e procedurave të prokurimit;
- Barazi dhe konkurrencë të lirë mes operatorëve ekonomikë;
- Efikasitet në menaxhimin e fondeve publike;
- Parandalim të konfliktit të interesit dhe korrupsionit.

II. Zbatimi i parimeve të prokurimit

Gjatë këtij gjashtëmujori, janë respektuar parimet themelore të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 6 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, përfshirë:

Ndershmëria dhe konkurrenca

- Të gjitha procedurat janë zhvilluar përmes konkurrencës së hapur ose procedurave të thjeshtuara ku ishte e aplikueshme.¹

^{1 1} Raporti gjashtëmujor i Zyrës së prokurimit publik në Komunën e Mitrovicës Veriore

- Njoftimet janë publikuar përmes platformës zyrtare të KRPP-së, duke garantuar pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve.²

Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi

- Të gjithë ofertuesit janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim në të gjitha fazat e prokurimit.
- Janë përdorur kritere të qarta, të përcaktuara më parë në dosjen e tenderit dhe janë respektuar nga komisionet e vlerësimit.

Transparenca

- Procesi i prokurimit është dokumentuar dhe çdo vendim i marrë është i justifikuar me dokumentacion përkatës.
- Vendimet për dhënie kontrate janë të publikuara dhe të qasshme nga publiku në sistemin elektronik të KRPP-së.

Përdorimi ekonomik dhe efikas i fondeve publike

- Krahasimi i vlerave të planifikuara me ato të kontraktuara tregon një **kursim të përgjithshëm** në disa kontrata.
- Është arritur eficiencë në realizimin e shërbimeve dhe punëve të parapara me kosto më të ulët, pa komprometuar cilësinë.

III. Përmbledhje e Procesit të Prokurimit

3.1 Numri i Procedurave të Prokurimit

Gjatë periudhës raportuese janë kontraktuar **gjithsej 19 procedura** për të cilat janë nënshkruar kontrata me operatorë ekonomikë.

Në vijim raporti:

Përmbledhje financiare:

Kategori	Totali i Vlerave të parashikuar (EUR)	Totali i Pagesave (EUR)
Furnizime	29,785.00	24,436.95
Shërbime	155,533.00	133,463.31
Punë infrastrukturore	950,431.00	857,929.23
TOTALI	1,135,749.00	1,015,829.49

1. Furnizime

Përshkrimi	Data Fillimit	Data Përfundimit	Operator Ekonomik	Vlera e parashikuar (EUR)	Vlera e Paguar (EUR)
Furnizim për Kompjuter Brand Name All IN One	31.10.2024	12.2.2025	ILIR - KOSOVA SH.P.K.	20,000.00	16,470.00
Blerja e Dy Fotokopjeve, Printer, Skaner	17.1.2025	14.3.2025	ILIR - KOSOVA SH.P.K.	8,000.00	6,183.20
Furnizim me NVR dhe pjesë përcjellëse	24.04.2025	30.4.2025	"ÇUFRA" SH.P.K.	825.00	824.75
Vendosja e Kamerave Shtese te Sigurise për Objektin e Administratës Komunale	14.04.2025	24.04.2025	N.P Informatika	960.00	959.00

2. Shërbime

Përshkrimi	Data Fillimit	Data Përfundimit	Operator Ekonomik	Vlera e parashikuar (EUR)	Vlera e Paguar (EUR)
Pastrim gjeneral i katit përdhese	22.1.2025	10.2.2025	BURIM S. TAHIRI B.I.	918.00	917.00
Vendosja e kamerave në hapësirat e Qendrës Sociale	5.2.2025	12.2.2025	N.P. " Informatika"	700.00	699.00
Folie Akull për xhamat e objektit administrativ	5.2.2025	12.2.2025	UMBRELLA SH.P.K.	875.00	875.00
Vendosja e Mbishkrimit me Llogo të Komunës	19.2.2025	25.2.2025	UMBRELLA SH.P.K.	990.00	990.00
Vendosja e tendës për organizimin e panairit	20.2.2025	26.2.2025	CANABEG HYSENI B.I.	700.00	700.00
Servisimi i Liftit në Objektin e Administratës	15.4.2025	24.4.2025	Perfect Elevator L.L.C.	990.00	989.75

Përshkrimi	Data Fillimit	Data Përfundimit	Operator Ekonomik	Vlera e parashikuar (EUR)	Vlera e Paguar (EUR)
Vendosja e Llogove me folie në hapësirat e Administratës Komunale	14.03.2025	20.03.2025	Umbrella SHPK	360.00	350.00
Mirëmbajtje (Pastrim) Higjienike e Brendshme (Zyret. Koridoret. Sallat e takimeve. Toaletet etj.) dhe e Jashtme (Oborri) e Objekteve të Komunës (ADMINISTRATE. QPS. Ish-SIZ.)	21.03.2025	19.06.2025	Er Fi.shpk Commerce	150,000.00	127,942.56 (Kontratë kornizë)

3. Punë infrastrukturore dhe të tjera

Përshkrimi	Data Fillimit	Data Përfundimit	Operator Ekonomik	Vlera e parashikuar (EUR)	Vlera e Paguar (EUR)
Rrënimi, Bartja, Magazinimi i Materialeve dhe Objekteve	12.2.2025	21.3.2025	Milazim Baliu B.I.	80,000.00	77.20 (Çmim per njësi) deri tani janë paguar 4200 Eu)Kontratë kornizë.
Rregullimi i Fushës Sportive tek Ura e Ibrit	27.2.2025	17.4.2025	N.N.P. "HYSNIA"	5,881.00	5,327.00
Rindërtimi i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit publik	3.3.2025	29.4.2025	FS C ING SH.P.K.	250,000.00	236,736.60
Rregullimi rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në Rr. Kolashinit	14.3.2025	1.5.2025	Grup Operatorë Rexha; AROMA PLUS; KRASNIQI SH.P.K.	250,000.00	248,123.00
“Ndertimi i Parkut rekreativ, shtigjeve të bicikletave”	10.3.2025	6.5.2025	Rexha	120,000.00	119,872.23

Përshkrimi	Data Fillimit	Data Përfundimit	Operator Ekonomik	Vlera e parashikuar (EUR)	Vlera e Paguar (EUR)
Rregullimi i rrugëve Xhon Kenedi; Tanasho Raiq etj.	17.3.2025	6.5.2025	Grup Operatorë Rexha; AROMA PLUS; KRASNIQI SH.P.K.	244,000.00	243,120.40
“Rregullimin e Hyrjes së Objektivit dhe Pajisjet përcjellëse”	5.5.2025	15.5.2025	IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë	550.00	550.00

Procedurat e Anuluara

Kodi Intern i Procedurës	Përshkrimi i Procedurës	Statusi I procedures	Arsyeja e Anulimit
647-25-3295-1-4-7	Furnizim me NVR dhe pjesët përcjellëse për nevojat e objektit komunal	ANULUAR	Problemet teknike ne sitemin e e-prokurimit
647-25-312-2-2-1	Rrënimi, Bartja, Magazinimi i Materialeve, Mallrave dhe Objekteve si dhe Hudhja në Deponi te Materialeve dhe Mallrave te Sekuestruara - Konfiskuara	ANULUAR	Refuzim për mungesë ofertave
647-25-3540-5-4-7	Rregullimin e Hyrjes së Objektivit dhe Pajisjet përcjellëse	ANULUAR	Refuzim për mungesë ofertave
647-25-4149-1-2-1	Blerja e 3 E-kiosqeve (1 në objektin komunal dhe 2 në qytet)	ANULUAR	Asnjë operatore pjesëmarrës nuk ka permbushur kriteret e përgjegjshmërisë
647-25-4664-5-2-1	Ndërtimi i parkut afër objektit të Komunës së Mitrovicës Veriore	ANULUAR	Asnjë operatore pjesëmarrës nuk ka permbushur kriteret e përgjegjshmërisë

Kodi Intern i Procedurës	Përshkrimi i Procedurës	Statusi I procedures	Arsyeja e Anulimit
647-25-5230-2-2-1	Ofrimi i Shërbimeve me Autobartje dhe pjesët tjera përcjellëse	ANULUAR	Refuzim për mungesë ofertave

Procedurat në Proces

Kodi Intern i Procedurës	Përshkrimi i Procedurës	Statusi I procedures
647-25-5282-5-2-1	Rregullimi i varrezave muslimane ne Mitrovicen Veriore	Në proces
647-25-5736-1-2-1	Blerja e 3 E-kiosqeve (1 në objektin komunal dhe 2 në qytet)	Në proces

Procedurat në OSHP

Procedurat në APEL -OSHP
Data :07.07.2025
Sigurimi Fizik dhe me Alarm i Objekteve Komunale ne rr. Kollashini si dhe Objekti QPS-së- 647-25-5386-2-2-1

Procedurat e shitjes

Përshkrimi i Shitjes	Kodi	Vlera	Emri i Kompanisë	Adresa
Shitja e rrethojave të metalit	647-25-2387-2-6-10	1989 Euro	Hit Construction Shpk	Sheshi I dëshmorëve p.n, 22000 Dragash, Kosovë

IV. Objektivat për Periudhën e Ardhshme

Në periudhën e ardhshme, Zyra e Prokurimit Publik do të angazhohet me përgjegjësi të plotë dhe përkushtim maksimal në realizimin e të gjitha projekteve të planifikuara në kuadër të

planifikimit preliminar dhe përfundimtar për vitin 2025. Zbatimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet duke respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke ndjekur në përpikëri udhëzimet dhe rregulloret administrative të Komisionit për Rregullimin e Prokurimit Publik (KRPP) dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (AQP).

Në përputhje me synimin për të përmirësuar vazhdimisht efikasitetin dhe integritetin e proceseve të prokurimit, Zyra do të vlerësojë dhe implementojë praktikën më të mira profesionale dhe standardet ndërkombëtare, duke theksuar veçanërisht nxitjen e transparencës dhe konkurrencës së ndershme në të gjitha procedurat e prokurimit publik.

Për realizimin e këtyre objektivave, do të ndërmerren masa konkrete për zhvillimin dhe avancimin profesional të stafit, duke i mundësuar atij akses të vazhdueshëm në trajnime të specializuara dhe përvetësimin e njohurive të avancuara në fushën e prokurimit publik.

Njëkohësisht, Zyra e Prokurimit Publik do të fokusohet në forcimin e bashkëpunimit institucional me institucionet qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë, në mënyrë që të sigurohet mbështetja financiare dhe teknike e nevojshme për realizimin e projekteve strategjike, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Në këtë kontekst, përkushtimi i palëkundur ndaj punës me përgjegjësi të lartë, respektimi rigoroz i normave ligjore dhe etike, si dhe angazhimi i vazhdueshëm për përvetësimin e njohurive dhe metodologjive të reja në fushën e prokurimit publik do të vazhdojnë të jenë parimet themelore që udhëheqin dhe përcaktojnë aktivitetin e Zyrës së Prokurimit.

V. Përfundim

Gjatë periudhës raportuese **01 janar – 30 qershor 2025**, **Zyra e Prokurimit në Komunën e Mitrovicës Veriore** ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit në përputhje me dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042**, të ndryshuar dhe plotësuar me **Ligjin Nr. 04/L-237**, **Ligjin Nr. 05/L-068**, si dhe **Ligjin Nr. 05/L-092**, duke ndjekur parimet themelore të transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe menaxhimit efikas të fondeve publike.

Në bazë të të dhënave të prezantuara në këtë raport, vërehet se janë ndjekur procedurat e parapara ligjore dhe është mundësuar zhvillimi i kontratave publike në mënyrë të hapur dhe të drejtë. Megjithatë, përkundër përmbushjes së obligimeve ligjore, janë identifikuar disa sfida që lidhen kryesisht me nevojën për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve profesionale, përmirësimin e planifikimit të prokurimit dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e kontratave.

Për të garantuar një sistem të prokurimit publik më cilësor dhe të qëndrueshëm, rekomandohet që:

- Të vazhdohet me trajnime dhe ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit;
- Të përmirësohet planifikimi dhe koordinimi ndërmjet njësive kërkuese dhe Zyrës së Prokurimit;
- Të fuqizohet mbikëqyrja e zbatimit të kontratave për të siguruar cilësi dhe përmbushje të obligimeve nga OE-të;
- Të aplikohet në mënyrë të rreptë parimi i transparencës dhe të zbatohen mekanizmat e mbrojtjes së integritetit në prokurim.

Në përfundim, raporti konfirmon angazhimin e palëvizshëm të Autoritetit Kontraktues **Komunës së Mitrovicës Veriore** për të ndjekur standardet më të larta të prokurimit publik dhe për të kontribuar në zhvillimin e një sistemi të drejtë, efikas dhe të besueshëm në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit lokal.

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Bazuar në kërkesën për raportim për periudhën Janar – Qershor 2025, në vazhdim gjeni raportin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

RAPORTI 6 MUJOR I NJESISE PER MENAXHIMIN E BURIMEVE NJEREZORE (Periudha 01.01.2025 – 30.06.2025)

Me ligjin e Buxhetit për vitin 2025 Komuna e Mitrovicës Veriore ka pasur gjithsej 830 pozita të autorizuar për Zyrtarët Publik përfshirë nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësit e shërbimit publik, nëpunësit teknik dhe mbështetës, si dhe zyrtarët e kabinetit (të zgjedhurit apo emëruarit).

Plani i Personelit për vitin 2025 - Me Planin e Personelit për vitin 2025 janë parashikuar 44 pozita të lira të buxhetuara për pranim në kategorinë e shërbimit civil, nga të cilat 39 në kategorinë profesionale, 1 në kategorinë specialist, 2 në kategorinë drejtues i ulët dhe 2 teknik mbështetës.

Realizimi i Planit të Personelit deri me 30.06.2025 – Gjatë periudhës raportuese janë shpallur gjithsej 55 konkurse publike për pranim në shërbimin civil, prej të cilave:

- 4 për kategorinë drejtues i ulët,
- 46 për kategorinë profesionale,
- 1 për kategorinë specialist dhe
- 4 të nivelit teknik dhe mbështetës.

Nga të gjitha këto konkurse të shpallura deri më tani:

- 29 kanë përfunduar me sukses,
- 15 kanë dështuar (por janë rishpallur në ndëkohë) dhe
- 11 janë ende në procedurë rekrutimi.

Nga 29 konkurse të përfunduara me sukses kanë rezultuar 37 kandidat te suksesshëm, të cilët kanë filluar marrëdhënien e punës.

- **Procedurat e rekrutimit për zyrtarët publik**

Kategoria e zyrtarëve	Numri i shpalljeve	Numri i kandidateve te suksesshëm
Nëpunës i shërbimit civil	51	35
Nëpunës teknik dhe mbështetës	4	2
Gjithsej	55	37

- **Numri i zyrtarëve publik të punësuar në periudhën Janar-Dhjetor 2025**

Kategoria e zyrtarëve publik	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Drejtör/Zyrtar të kabinetit
Gra	15	0	1
Burra	25	2	1
Gjithsej	40	0	2

- **Përkatësia etnike e nëpunësve të shërbimit civil të punësuar në periudhën Janar-Dhjetor 2025**

Në tabelën në vazhdim është pasqyruar përkatësia etnike e të punësuarve gjatë periudhës raportuese

Nacionaliteti	Kategoria e ulët Drejtuese	Kategoria e Specialistëve	Kategoria Profesionale	Kategoria teknik dhe mbështetës	Gjithsej
Shqiptar	1		37	2	40
Serb			1		1
Boshnjak					
Turq					
Goran					
Rom					
Ashkali					
Egjiptian					
Tjetër			1		1

- **Transferimet**

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar katër (4) transferime të brendshme, si në tabelën në vijim:

Titulli i ri i pozitës së punës	Lloji i transferimit	Data e fillimit
Inspektor i Shërbimeve Publike	Transfer i brendshëm	15.04.2025
Zyrtar për komunitete	Transfer i brendshëm	01.04.2025
Zyrtar i lartë për burime njerëzore dhe paga	Transfer i brendshëm	27.01.2025
Asistent administrativ	Transfer i brendshëm	20.01.2025

- **Pozitat në kategorinë Drejtues i ulët në komunë**

Gjithsej 5 pozita janë në kategorinë drejtues të ulët, prej të cilave 3 burra dhe 2 gra.

Numri i përgjithshëm i zyrtarëve në kategorinë Drejtues i ulët	
Burra	3
Gra	2
Gjithsej	5

- **Pozitat për kategoritë drejtues i ulët - ushtrues detyre**

Gjithsej 6 pozita udhëheqëse – drejtues të ulët janë mbuluar me ushtrues detyre, prej të cilave 3 burra dhe 3 gra.

Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë udhëheqës si ushtrues detyre në institucione komunale	
Burra	3
Gra	3
Gjithsej	6

- **Trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 në bashkëpunim me IKAP-in është organizuar trajnimi hyrës për nëpunësit, gjithsej 21 zyrtarë kanë vijuar trajnimin (6 module) dhe janë pajisur me certifikata.

Poashtu, komuna ka organizuar trajnimin, të mbajtur nga FLSA me titull “Inicimi i kërkesave, përgatitja e specifikacioneve teknike, zotimi i mjeteve financiare, zhvillimi i procedurave, lidhja e kontratave, menaxhimi, monitorimi i kontratave, pranimi i mallit, punëve shërbimit si dhe pagesat e faturave”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 16 zyrtarë, të cilët janë pajisur me certifikata.

Në periudhën raportuese janë organizuar trajnime të ndryshme nga niveli qendror, gjegjësisht Ministrinë dhe organizatat tjera, ku kanë marrë pjesë edhe zyrtarë nga komuna jonë, por pa përfshirjen e NJMBNJ.

- **Masat disiplinore dhe ankesat e zyrtarëve publik në vitin 2025**

Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Komune gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 nuk ka pranuar asnjë kërkesë për inicim të procedurës disiplinore dhe rrjedhimisht nuk ka pasur asnjë procedurë.

Periudha Janar – Qershor 2025		
Masa për shkelje të lehta disiplinore		0
Masat për shkelje të rënda disiplinore	Ndalimi nga 20% deri në 50% e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.	0
	Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite.	0
	Transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjta.	0
	Ulja në pozitë	0
	Pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj.	0
	Pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës baze, deri në një (1) vit.	0
	Largimi nga Puna.	0

- **Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2024**

Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2024 - Procesi i vlerësimit në SIMBNJ për nëpunësit civil për vitin 2024 është përfunduar deri më 28 Shkurt të vitit 2025. Vlerësimi është realizuar në formatin elektronik përmes sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore nga mbikqyrësit relevant. Rezultatet janë si më poshtë:

Numri i nëpunësve të vlerësuar:	35
Tejkalon pritshmërinë	5
Arrin pritshmërinë	29
Ka nevojë për përmirësim	1

- **Klasifikimi i Vendeve të Punës në Shërbimin Civil**

Pas aprovimit të klasifikimit të vendeve të punës, janë përgaditur akt emërimet e reja (fillimisht për pozitat që kanë pësuar ndryshime – 14 akt emërimet të reja) dhe janë proceduar në Thesar. Ndërkohë po vazhdohet me përgaditjen e akt emërimeve tjera si dhe përshkrimet e punës për të gjithë zyrtarët, sipas klasifikimit të aprovuar.

- **Punët tjera në NJMBNJ**

- Menaxhimi i proceseve të rekrutimit, emërimit, transferimit dhe çdo procesi tjetër që ndërlidhet me zyrtarë publik;
- Administrimi / përditësimi i dosjeve fizike dhe elektronike të të gjithë zyrtarëve;
- Kërkesa për kartela identifikuese për zyrtarët e ri dhe të tjerëve sipas nevojës;
- Krijimi i qasjen në SIMBNJ për zyrtarë të ri;
- Kalkulimi dhe përgaditja e vendimeve për përvojën e punës për zyrtarët e rinj;
- Organizimi i trajnimeve për nëpunësit civil për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale;
- Përgaditja e dokumentacionit për Divizionin e Pagave në Thesar/MF në baza mujore, ku përfshihen të gjitha ndryshimet si: punëtorët e rinj, transferimet, dorëheqjet/largimet, pagesat retroaktive, pagesat për anëtarët e kuvendit, etj.
- Monitorimi i pushimeve të zyrtarëve dhe azhurimi i dosjeve të pushimit;
- Arkivimi i dosjeve të rekrutimeve dhe dosjeve personale të zyrtarëve;
- Përgaditja e të dhënave për raportim në Sistemin për Menaxhimin e Performancës (SMPK);
- Përgaditja e shkresave të ndryshme sipas kërkesave nga zyrtarët, si dhe punë të tjera rutinore.

ZYRA PËR INFORMIM

Raporti i Punës i Zyrës për Informim për Periudhën Janar-Qershor 2025

Në përputhje me kërkesën për raportin gjashtëmuor për periudhën Janar-Qershor 2025, Zyra për Informim në Komunën e Mitrovicës Veriore ka realizuar shumë aktivitete dhe angazhime gjatë periudhës Janar-Qershor 2025. Ky raport ka për qëllim përmbledhjen dhe pasqyrimin e detajuar të aktiviteteve, angazhimeve dhe detyrave të realizuara nga Zyra për Informim, me fokus të veçantë në rolin e saj të rëndësishëm në mbështetje të transparencës dhe komunikimit ndërmjet administratës komunale, Kryetarit të Komunës dhe qytetarëve. Gjithashtu, në këtë raport janë përfshirë përpjekjet për përmirësimin e kanaleve të informimit dhe mënyrat e reja të komunikimit me publikun.

Aktivitete dhe Angazhime të Zyrës për Informim (Janar-Qershor 2025)

1. Përshtatja dhe Përditësimi i Webfaqes Zyrtare të Komunës:

Në periudhën e analizuar, Zyra për Informim ka pasur një rol kyç në përditësimin e webfaqes zyrtare të Komunës së Mitrovicës Veriore. Ky proces ka përfshirë jo vetëm një përditësim të informacionit dhe përmirësimin e strukturës së faqes, por gjithashtu pasurimin e përmbajtjes dhe përshtatjen e saj për një navigim më të lehtë nga qytetarët. Ky hapi ka pasur për qëllim sigurimin e një forme më efikase të komunikimit dhe informimit me qytetarët.

2. Publikimi i Vendimeve dhe Materialeve:

Zyra për Informim ka pasur një angazhim të vazhdueshëm në dokumentimin dhe shpërndarjen e vendimeve të marra nga Zyra e Kryetarit, si dhe publikimin e materialeve dhe dokumenteve të tjera nga drejtorit e ndryshme të Komunës, si Drejtoria e Financave, Drejtoria e Administratës së përgjithshme, Drejtoria për Kulturë, rini dhe sport, Zyra e Prokurimit etj. Publikimi i këtyre materialeve ka për qëllim përmirësimin e transparencës dhe qasjen e qytetarëve në informacionin që i përket politikave dhe aktiviteteve të Komunës.

3. Aktivitetet në Rrjetet Sociale dhe Kanale të Tjera të Informimit:

Një nga angazhimet kryesore të Zyrës për Informim ka qenë rritja dhe përmirësimi i pranisë dhe komunikimit në rrjetet sociale. Për këtë qëllim, janë menaxhuar llogaritë në rrjete sociale si Instagram, Twitter dhe YouTube, duke përdorur gjithashtu llogaritë si Facebook dhe profilin zyrtar të Kryetarit të Komunës, për shpërndarjen e informacionit në kohë reale për aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorive komunale. Zyra ka pasur një angazhim të vazhdueshëm për të informuar qytetarët mbi aktivitetet e Kryetarit, takimet dhe vizitat, si dhe pjesëmarrjen në ngjarje publike, aktivitete kulturore dhe edukative, përmes këtyre platformave.

4. Përcjellja dhe Publikimi i Aktiviteteteve të Kryetarit të Komunës:

Zyra për Informim ka ndjekur dhe raportuar aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës, duke përfshirë takimet brenda dhe jashtë komunës me institucione të tjera dhe partnerë ndërkombëtarë. Zyra ka monitoruar gjithashtu ndikimin e këtyre aktiviteteve tek qytetarët.

5. Aktivitetet dhe Ngjarjet Publike të Komunës:

Përmes platformave të ndryshme informuese, Zyra për Informim ka siguruar informacione për qytetarët lidhur me aktivitete dhe ngjarje të rëndësishme për Komunën dhe shoqërinë, duke përfshirë evenimente edukative, kulturore dhe ekologjike. Disa prej aktiviteteve më të rëndësishme që janë përkujdesur për to janë: “Dita Nërkombëtare e Tokës” më 22 prill, “Dita botërore e Librit” 23 prill dhe shumë aktivitete të tjera.

6. Informimi për Investimet në Infrastrukturë:

Një tjetër fushë e rëndësishme e punës së Zyrës për Informim ka qenë informimi i qytetarëve për investimet dhe ecurinë e projekteve të infrastrukturës në Komunë. Pjesë e këtij angazhimi ka qenë shpërndarja e informacionit për rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve në: Rruga drejt Zveçanit, Rr. Xhon Kenedi, Rr. Tanasko Rajiq, Rr. Vasilie Ostrovski, Rr. Filip Vishnjq, duke përdorur fotografi dhe përditësime të detajuara për qytetarët.

7. Publikimi i Njoftimeve të ndryshme:

Zyra ka informuar qytetarët për njoftimet e rëndësishme nga drejtoritë përkatëse të Komunës, përfshirë njoftimet për dëgjime publike, njoftime për fillimin e legalizimit, rastet emergjente dhe mundësitë për subvencione që Komuna ofron për qytetarët.

8. Caktimi i Zyrtarëve për Informim në proceset Zyrtare:

Me vendim të Kryetarit, janë caktuar zyrtarë për monitorimin e proceseve të ndryshme:

- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, anëtarë në Ristrukturimin e vendeve të punës.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, anëtar në komision për rekrutimin e stafit.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, anëtarë në grupin punues për “Raportim të Performancës Komunale”
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, anëtarë në “Grupin punues për dëgjime buxhetore”

9. Trajnime Profesionale për Zyrtarët për Informim:

Në periudhën e analizuar, zyrtarët për informim kanë kaluar një sërë trajnimesh dhe aktivitete zhvillimore siq janë:

Trajnimi për “Planifikimin e hershëm Buxhetor”

Trajnimi për “Raportimi për Performancë Komunale”

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025:

- Gjithsej mbledhje të Kuvendit të Komunës të mbajtura, 6 mbledhje të rregullta, 3 mbledhje të jashtëzakonshme, 1 mbledhje Solemne.
- Gjithsej njoftime publike për mbledhjet e kuvendit, 2.
- Gjithsej numëri i mbledhjeve të transmetuara online, nuk ka.

Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët:

- Numëri i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumentet publike, nuk ka.

Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës.

- Gjithsej numëri i akteve të nxjera nga Kryetari i Komunës që janë me interes të përgjithshëm publik, 14, të gjitha të publikuara në faqen zyrtare të komunës.

Mbledhjet e kuvendit me pjesëmarrje të Kryetarit të Komunës,

- Gjithsej 2 mbledhje me prezenc të kryetarit.
- Gjithsej 6 mbledhje të rregullta, 3 mbledhje të jashtëzakonshme.

Përfundim dhe Vlerësim i Performancës së Zyrës për Informim:

Zyra për Informim ka pasur një rol të pandërprerë dhe të rëndësishëm në përmirësimin e komunikimit dhe transparencës ndërmjet Komunës dhe qytetarëve gjatë periudhës Janar-Qershor 2025.

Aktivitetet e realizuara dhe angazhimet e Zyrës për Informim kanë kontribuar në rritjen e nivelit të angazhimit të qytetarëve dhe përmirësimin e lidhjeve me administratën komunale. Pjesëmarrja e vazhdueshme në zhvillimin e komunikimit të dyanshëm, si dhe përmirësimi i kanaleve të informacionit, kanë siguruar që qytetarët të kenë qasje të lehtë në informacionet e nevojshme për jetën e përditshme dhe proceset vendimmarrëse në Komunë.

Zyra do të vazhdojë të investojë në rritjen e efikasitetit të komunikimit dhe të mbajë një nivel të lartë transparence dhe përgjegjshmërie ndaj qytetarëve dhe institucioneve.

ZYRA LIGJORE

RAPORTI I PUNËVE TË ZYRËS LIGJORE PËR 6 MUJORIN E PARË TË VITIT 2025

Hyrje

- Bazuar në kërkesën për raportim në periudhën Janar – Qershor 2025, zyra ligjore në komunën e Mitrovicës Veriore sipas detyrave të saj zyrtare për këtë periudhë ka kryer punët si në vijim:

Aktivitetet e përgjithshme

- Ky raport përmbledh aktivitetet dhe angazhimet e Zyrës Ligjore në Komunën e Mitrovicës Veriore, qëllimi i këtij raporti është të paraqesë punën e realizuar, sfidat e hasura dhe rekomandimet e dhëna nga zyra për përmirësimin e funksionimit të shërbimeve juridike brenda Komunës.
- Zyra Ligjore në vazhdimësi ka ofruar mbështetje profesionale për strukturat komunale, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë në të gjitha veprimtaritë institucionale.
- Zyra Ligjore në kuadër të detyrave të saj për periudhën e parë të vitit 2025 (Janar-Qeshor), ka ofruar këshilla ligjore për drejtoritë, kabinetin dhe njësit Komunale, ka hartuar dhe rishikuar kontrata, marrëveshje dhe akte të ndryshme Komunale, ka marrë pjesë në Komisione Komunale për shqyrtimin e ankesave dhe lëndëve të kontestueshme gjithashtu monitorim të zbatimit të legjislacionit dhe përputhshmërisë ligjore të vendimeve të marra nga Komuna.
- Me vendim të kryetarit janë caktuar zyrtarët ligjor anëtar/kryesues të komisioneve- grupeve punuese për hartimin e Rregulloreve komunale.
Zyra ligjore ka hartuar Rregulloren Komunale nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale. Rregullorja në fjalë nr.06/2025 është në fazën përfundimtare dhe vetëm pritet konfirmimi i ligjshmërisë i ministrive përkatëse për fushat e caktuara.
Nga zyra ligjore gjithashtu është punuar edhe Rregullorja nr.02/2025 Për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, ku pas korigjimit të rregullores sipas rekomandimeve të MMPHI-së e njeta e ka marr konfirmimin e ligjshmërisë dhe është publikuar në faqen zyrtare të Komunës dhe tashmë është në zbatim.
- Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor anëtar i komisionit për hartimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptas 2024-2027 (Gjatë këtij 6 mujori nuk është mbajtur ndonjë takim apo nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet në kuadër të këtij plani).
- Me vendim të kryetarit është emëruar zyrtari ligjor anëtar në tri komisione për zhvillimin e procedurave të rekrutimit të stafit të ri (procedurat për komisionet e cekura janë të përfunduara).
- Gjithashtu është caktuar zyrtari ligjor kryesues i komisionit disiplinor për zhvillimin e procedurave disiplinore (të gjitha procedurat e iniciuara janë të përfunduara).
- Nga zyra ligjore me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit në institucionin e komunës së Mitrovicës Veriore, i cili ka mbajtur trajnime për këtë fushë, gjithashtu janë përmbushur edhe raportimet pranë Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit.

- Po ashtu nga zyra ligjore është caktuar Koordinator për raportim mbi performancën komunale, në këtë funksion ka marrë pjesë në trajnime dhe kryerjen e aktiviteteve që lidhen me performancën komunale. Në periudhën e parë të vitit 2025 Komuna jonë ka raportuar me sukses për procesin e performancës në sistemin e menagjimit të performances (SMPK).
- Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit komunal, dhe për këtë raportohet për periudhat 6 mujore në Agjencionin për Parandalimin e Korrupsionit.
- Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor anëtar i komitetit koordinues në komunën e Mitrovicës Veriore për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për qeverisje të hapur 2023-2025 (përgjatë këtij 6 mujori nuk është mbajtur ndonjë takim apo aktivitet).
- Përfaqësuesi ligjor i komunës ka marrë pjesë në trajnimin 2 ditor të organizuar nga Asociacioni i komunave të Kosovës me temë: Rëndësia e Ligjit Nr. 8/L-182 Për Konfliktet Administrative.
- Sipas vendim të datës: 16.12.2020 nga zyra ligjore është emëru zyrtar për mbrojtje nga diskriminimi, i cili në vazhdimësi në koordinim me zyrën për të drejtat e njeriut në kuadër të MAPL-së dhe Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, mbajnë aktivitete që mbulojnë fushën për promovimin, avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Gjatë periudhës janar – qershor 2025 nuk ka pasur asnjë aktakuzë të ngritur ndaj zyrtarëve komunal dhe si rrjedhojë nuk ka pasur as pezullime.
- Gjatë periudhës janar - qershor 2025 zyra ligjore në koordinim me kabinetin e kryetarit kanë udhëhequr procedurat e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronë private me qëllim të krijimit të kushteve për ndërtimin e një qerdhe publike për fëmijë. Të gjitha procedurat e këmbimit kanë përfunduar dhe prona është këmbyer. Ky projekt vazhdon deri në përfundimin e të gjitha punimeve për ndërtimin e koptshtit (qerdhes).
- Zyrtarë nga zyra ligjore, kanë marr pjesë në kolegjiunin e zyrtareve ligjor të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Me mbështetjen e Asociacionit të Komunave të Kosovës për Komunat Veriore është organizuar një punëtori dyditore me qëllim të ofrimit të ndihmës Komunës në përpilimin e Rregulloreve Komunale.

Lehtësimi i barrës administrative

- Me vendim të kryetarit janë caktuar zyrtarët ligjor në komisionin për zhvillimin e procedurës për lehtësimin e barrës administrative (nga takimet e mbajtura dhe zhvillimin e kësaj procedure janë thjeshtëzuar 10 (dhjetë) shërbime administrative nga drejtorit të ndryshme).
- Në Kuadër të këtij projekti nga Zyra për Planifikim Strategjik e Kryeministrit të Kosovës në bashkëpunim me Organizatat joqeveritare GIZI dhe PIPOS, për Komunën tonë janë përgaditur 70 formular të cilat janë shpërndarë nëpër drejtori/sectorë që ka për qëllim inventarizimin dhe analizimin e shërbimeve Komunale në të gjitha Komunat e Kosovës, me fokus të veçantë në thjeshtimin e këtyre shërbimeve për qytetarët.

Rregulloret komunale të hartuara nga zyra ligjore në bashkëpunim me drejtorit përkatëse:

Numri rendor	Emërtimi	Data
1	Rregullore komunale për taksa tarifa dhe gjobat komunale	Janar - Qershor 2025
2	Rregullore komunale për transportin rrugor në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore	Janar – Qershor 2025

PËRFASIMI LIGJOR PRANË GJYKATAVE

Janar 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.89/18	27.01.2025

Shkurt 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr. 57/21	04.02.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr. 751/2007	07.02.2025
Përpilim i ankesës për Gjykatën Komerciale KA.nr 47/25	07.02.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr. 87/15	11.02.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr. 1276/23 dhe 2241/23	27.02.2025
Përpilim i kallëximit penal kundër A. A	27.02.2025
Përpilim i Revizionit AC.nr.5332/2024	27.02.2025

Mars 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2251/24	03.03.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.871/15	05.03.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.144/18,284/18,317/18 dhe 122/18	14.03.2025

Prill 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr . 317/28	01.04.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr .284/18	01.04.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr 2222/24	07.04.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2244/2023	07.04.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2230/24	07.04.2025
Përgjigje ne padi A.nr. 4990/24	10.04.2025
Përgjigje ne padi A.nr 4993/24	17.04.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.1277/23	24.04.2025

Maj 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përpilim i përgjigjes ne ankese	25.05.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2244/2023	21.05.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2222/2024	21.05.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.2230/2024	21.05.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.888/2018	26.05.2025

Qershor 2025

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim ne seance gjyqesore C.nr.1280/23	13.06.2025
Përpilim i ankesave kundër aktgjykimeve C.nr.222/24,Cnr.2244/2023,C.nr.2230/24	16.06.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore- C.nr. 1277/23	25.06.2025
Përfaqësim në seancë gjyqësore C.nr.08/16	26.06.2025

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Përmbajtja

Sektori i Gjendjes Civile	23
Sektori i Punëve të Përbashkëta.....	25
Qendra për Shërbime me Qytetarë	26
Arkivat	26
Sektori për Teknologji Informativ.....	27
Projektet kapitale për 2025 dhe 2026	27
Rekrutimet	28

Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, ky sektor ka ofruar shërbime të vazhdueshme për qytetarët pa dallim nacionaliteti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shërbimet kanë përfshirë lëshimin e certifikatave të ndryshme, regjistrimin e lindjeve, vdekjeve, kurorëzimeve si dhe dokumente e procedura të tjera të natyrës civile.

Aktivitetet kryesore të realizuara kanë të bëjnë me dorëzimin e certifikatave për qytetarë brenda dhe jashtë vendit, zbatimin e procedurave për regjistrime të mëvonshme sipas kërkesave ligjore dhe në bazë të udhëzimeve administrative të përcaktuara, bashkëpunim me zyrtar në nivel qendror dhe lokal- komunal për mbarëvajtjen e procedurave, si dhe trajnime dhe pjesëmarrje për stafin me kërkesë të organeve kompetente, në aktivitete të ndryshme.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabelen me sasinë e dokumenteve të lëshuara nga ky sektor:

Nr.	Dokumenti	Sasia e lëshuar
1.	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	5761
2.	Certifikatë e Lindjes	1462

3.	Certifikatë e Vdekjes	479
4.	Certifikatë e Martesës	431
5.	Certifikatë e Vendbanimit	81
6.	Certifikatë e Gjendjes Martesore	72
7.	Certifikatë e Shtetësisë	19

Kurse sa i përket dokumenteve të konfirmuara me procedurë të veçantë:

Nr.	Dokumenti	Sasia e lëshuar
1.	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjeve në librat e gjendjes civile	755
2.	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve në librat e gjendjes civile	219

Spektori i Gjendjes Civile punon me një staf jo të kompletuar me mungesë të Udhëheqësit të Sektorit, procedurë e cila është marrë parasysh dhe po punohet në këtë drejtim, por edhe me kompletimin e pozitës së sipërpërmendur, numri i stafit është krahasimisht i vogël në raport me numrin e kërkesave e si rrjedhojë ndonjëherë kërkohet fleksibilitet dhe punë me palë edhe pas orarit normal.

Mirëpo, në aspektin e përgjithshëm procedurat dhe shërbimet kryhen në baza ditore të rregullta, pa vonesa dhe probleme si dhe zyrtarët e Gjendjes Civile dorëzojnë raporte në baza javore tek Drejtori i Administratës së Përgjithshme.

Bashkangjitur këtij raporti, gjeni edhe statistikën për shërbimet e Gjendjes Civile, të cilat janë nxjerrë nga Platforma elektronike E-Kosova.

Spektori	Dokumenti	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjendja civile	Shkarko "Ekstraktin"	588	292	296
Gjendja civile	Shkarko "Ekstraktin" për anëtar të familjes	473	197	276
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e lindjes" për anëtar të familjes	249	101	148
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e lindjes"	186	116	70
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e martesës"	156	95	61
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e vdekjes" për anëtar të familjes	46	30	16
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e martesës" për anëtar të familjes	38	21	17
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e bashkësisë familjare"	32	25	7
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e shtetësisë"	24	19	5
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e shtetësisë" për anëtar të familjes	15	3	12
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e bashkësisë familjare" për anëtar të familjes	7	3	4

Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e statusit martesor"	7	5	2
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e vendbanimit" për anëtar të familjes	6	5	1
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e statusit martesor" për anëtar të familjes	1	0	1
Gjendja civile	Shkarko "Certifikatën e vendbanimit"	1	1	0

Sektori i Punëve të Përbashkëta

Sektori i punëve të përbashkëta përbën një pjesë mbështetëse të rëndësishme të funksionimit të rregullt të Administratës komunale.

Aktivitetet kryesore të **përkthyesve** për këtë periudhë kanë qenë: përkthimi i dokumenteve zyrtare (nga gjuha Shqipe në gjuhën Serbe dhe anasjelltas), pjesëmarrja në seanca komunale, takime ndërinstitutionale dhe procese administrative ku është kërkuar përkthimi simultan etj.

- Nga 18 janari deri më 30 qershor, çdo të shtunë dhe të diel, inspektorët patrolluan 13 rrugë kryesore të qytetit, tregun e gjelbër dhe tregun ilegal pranë stacionit të autobusëve; pas aksionit të prillit ky treg ilegal u bë pothuajse jo-funksional;
- Masat kundër ushtrimit të veprimtarive pa regjistrim dhe në kushte të papërshtatshme rezultuan në regjistrimin e rreth 200 subjekteve pranë ARBK gjatë gjashtëmuajorit;
- Ndërtimet ilegale u ndaluan plotësisht, ndërsa u lëshuan lejet e para për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të klasës I & II.

1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Inspektimi i subjekteve afariste;
- Vizita dhe kontrolli në vendpunime/objekte ku kryhen punime ndërtimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Verifikimi i lejeve të punës dhe certifikatave të punës;
- Kontrolli i trafikut nga Inspektorati i Komunikacionit dhe ndërmarrja e masave kundër transportuesve ilegale;
- Kujdestari javore (çdo të shtunë/diel) në 14(mbi 5km) rrugë dhe tregjet kryesore, përfshirë tregun e gjelbër dhe tregun pranë stacionit të autobusëve;
- Trajtimi i kërkesave zyrtare;
- Trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Hartimi dhe ekzekutimi i akteve administrative;
- Inicimi i procedurave kundërvajtëse dhe penale;
- (Në pritje) Rekrutimi i Inspektorit të Mjedisit.

Aktivitetet në fjalë zëbërthehen në aktivitetet dhe veprime konkrete të cilat realizohen në bazë të planit ditor të Drejtorisë së Inspeksionit.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

2.1. Sektori i Shërbimeve Komunale:

- Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit publik dhe kanalizimit atmosferik;
- Inspektimi i kooperdorimit të ujit të pijshëm dhe shfrytëzimi racional i ujit;
- Inspektimi për dëmtimin e sipërfaqës publike;
- Inspektime nga fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Inspektime për gjendjen e pastërtisë në hapësirat publike;
- Kontrolla për vendosje konform ligjeve për mbishkrimet, panot dhe tabelat reklamuese;
- Inspektime tjera nga fusha e përgjegjësisë.

2.1.1. Pasqyra tabelare:

Përshkrimi i aktiviteteve	Numër
Inspektime planifikuar	250
Inspektime në terren me procesverbal	95
Riinspektim	250
Aktvendime për eliminim të parregullsive	1
Kërkesa zyrtare të trajtuara	0
Vendime për ekzekutimin e akteve administrative	1
Gjoha Administrative	2

2.2. Sektori i Ndërtimit

- Kontrolla inspektuese në parandalim të ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi i lejeve të ndërtimit dhe certifikatën përdorimit;
- Mbikëqyrja e ndërtimeve me leje ndërtimore;
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje;
- Inspektimi dhe lëshimi i certifikat të përdorimit;
- Mbikëqyrja e objekteve të vjetra;

2.2.1. Pasqyra tabelare

2.1.2 Sektori i Shërbimeve Komunale

Përshkrimi	Jan–Qer 2025
Inspektime me procesverbal	86
Ri-inspektime	883
Aktvendime për eliminim parregullsish	1
Vendime për ekzekutim	1
Gjoha administrative	2

2.1.3 Sektori i Ndërtimit

Përshkrimi	Jan–Qer 2025
Inspektime në terren	7
Inspektime konform U.A. 05/2017	7
Gjoha administrative	0
Kallëzime penale	0

2.1.4 Sektori i Tregut

Përshkrimi	Jan–Qer 2025
Inspektime në terren	2
Inspektime konform U.A. 05/2017	0
Gjoha administrative	0
Kallëzime penale	0

2.1.5 Asistenca nga Inspektorati Sanitar

Përshkrimi	Jan–Qer 2025
Inspektime në terren	40
Inspektime konform U.A. 05/2017	40
Gjoha administrative	10
Kallëzime penale	5

2.1.6 Inspektorati Komunikacionit

Përshkrimi	Jan–Qer 2025
Inspektime në terren	10
Inspektime konform U.A. 05/2017	10
Gjoha administrative	0
Kallëzime penale	0

2.2 Inspektimet javore në rrugë dhe tregje

Gjatë periudhës 18 janar – 30 qershor, çdo vikend (e shtunë dhe e diel) janë kryer 48 dalje patrulluese në 14 rrugët kryesore të qytetit, tregun e gjelbër dhe tregun ilegal pranë stacionit të autobusëve. Pas aksionit të prillit, në koordinim me Inspektoratin Sanitar, u konfiskuan dhe u asgjësuan 150 kg ëmbëlsira (paketime 100 g – 10 g), duke e bërë tregun ilegal pothuajse jo-funksional. Inspektimet adresuan gjithashtu uzurpimet e hapësirave publike, punën pa kushte të përshtatshme dhe pa regjistrim ligjor, gjë që kontribuoi në regjistrimin e rreth 200 subjekteve në ARBK. Ndërtimet ilegale u pezulluan, ndërsa u lëshuan lejet e para për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të klasës I dhe II.

Gjatë pesë operacioneve të përbashkëta—me asistencën e Inspektoratit Sanitar, kryesisht në orët e vona të natës dhe pa asnjë incident—ekipi ynë realizoi 40 kontrole të synuara. Si rezultat operacional, u konfiskuan disa qindra kilogram mish e peshk, djathë e nënprodukte qumështi, perime dhe nënprodukte patatesh, vezë dhe ëmbëlsira që nuk plotësonin standardet e ruajtjes ose kishin tejkaluar afatin e konsumit.

3. PËRMBLEDHJE KPI-sh

Indikatori kryesor	Viti 2025
Inspektime totale (dalje)	1028
Procesverbale	95
Gjoha të inkasuara	650 €
Produkte të konfiskuara (kg)	500+

4. AKSIONET E PËRBASHKËTA ME INSPEKTORATIN SANITAR

Në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe me mbështetjen e Policisë së Kosovës janë zhvilluar pesë aksione të fokusuara në mbrojtjen e shëndetit publik. 2.6 Inspektimet javore në rrugë dhe tregje

Gjatë periudhës 18 janar – 30 qershor, çdo vikend (e shtunë dhe e diel) janë kryer 48 dalje patrulluese në 14 rrugët kryesore të qytetit, tregun e gjelbër dhe tregun ilegal pranë stacionit të autobusëve. Pas aksionit të prillit, në koordinim me Inspektoratin Sanitar, u konfiskuan dhe u asgjësuan mbi 120 kg ëmbëlsira (paketime 100 g – 10 g), duke e bërë tregun ilegal pothuajse jo-funksional. Inspektimet adresuan gjithashtu uzurpimet e hapësirave publike, punën pa kushte të përshtatshme dhe pa regjistrim ligjor, gjë që kontribuoi në regjistrimin e rreth 200 subjekteve në ARBK. Ndërtimet ilegale u pezulluan, ndërsa u lëshuan lejet e para për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të klasës I dhe II. Gjatë pesë operacioneve të përbashkëta—me asistencën e Inspektoratit Sanitar, kryesisht në orët e vona të natës dhe pa asnjë incident—ekipi ynë realizoi 40 kontrolle të synuara. Si rezultat operacional, u konfiskuan disa qindra kilogram mish e peshk, djathë e nënprodukte qumështi, perime dhe nënprodukte patatesh, vezë dhe ëmbëlsira që nuk plotësonin standardet e ruajtjes ose kishin tejkaluar afatin e konsumit. Gjatë këtyre aksioneve janë konfiskuar dhe asgjësuar:

- >220 kg mish pa prejardhje ose me ruajtje të papërshtatshme;
- >110 kg ëmbëlsira e çokollata me afat të skaduar;
- >90 kg produkte bulmeti jashtë kushteve higjienike;
- >60 kg produkte higjienike të paautorizuara;
- >70 kg produkte të tjera ushqimore.

Asgjësimi është kryer në deponinë rajonale Zubin Potok në prani të inspektorëve sanitarë e komunalë. Vlera tregtare e mallit të asgjësuar vlerësohet mbi 15 000 €.

II. OBJEKTET E MBYLLURA PËRKOHËSISHT PËR SHKAK TË PARREGULLSIVE SANITARE DHE JURIDIKE

1. **"Tri Sheshira"** – kushte sanitare të papërshtatshme; objekti i ndërtuar në pronën e ndërmarrjes publike "Trepça Sh.A" pa të drejtë shfrytëzimi; dhënie e kundërligjshme me qira palëve të treta. "Trepça" Sh.A është në proces dhe po ndërmerr masa ligjore-administrative për lirimin dhe kthimin e parcelës së uzurpuar, në përputhje me dispozitat për menaxhimin e pronës shoqërore dhe legjislacionin në fuqi.
2. **"Hilltop"** – mungesë e kushteve teknike dhe higjienike për veprimtari gastronomike.
3. **Restorant "BB"** – i vendosur mbi truall komunal pa leje; probleme serioze në aspektin sanitar dhe urbanistik.
4. **"Unipek28"** – objekt i improvizuar (garazhë) në hapësirë publike, pa asnjë të drejtë juridike dhe pa leje sanitare.
5. **Klubet e natës në objekte të përkohshme** – të vendosura në hapësira publike të uzurpuara; pa dokumentacion afarist dhe pa kushte higjieno-sanitare.
6. Më 21 qershor, Inspektorati komunal mbylli marketin në rrugën "Princ Milloshi" dhe i dha një vërejtje zyrtare qebaptores "Bektešević" rr. Çlirimi. Mallrat e sekuestruara—mish, produkte qumështi, lëngje dhe ëmbëlsira, me peshë totale mbi 50 kg—u asgjësuan në përputhje me procedurat inspektive.

III. MALLRAT E KONFISKUARA DHE TË ASGJËSUARA

Kategoria	Sasia (kg)	Parregullsia
Mish pa prejardhje	200+	Pa deklarim, ruajtje në temperatura të papërshtatshme

Kafe me afat të skaduar	100	Jashtë standardeve të konsumit
Produkte qumështi	50	Ruajtje në kushte të papërshtatshme
Krem çokollate	200	Pa etiketim të plotë dhe ruajtje jo sterile
Ëmbëlsira të skaduara	60	Produktet të ndaluara për tregtim

e produkteve të konfiskuara është **asgjësuar në deponinë rajonale në Zubin Potok**, në praninë e inspektorëve dhe sipas standardeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

4. ANALIZË E PERFORMANCËS

Ulja e procesverbaleve krahasuar me vitin paraprak shpjegohet me:

- Fushata vetë-deklarimi dhe edukimi të operatorëve;
- Fokusim në inspektime këshilluese në vend të masave ndëshkuese;
- Rritje të transparencës dhe dixhitalizimit të komunikimit me bizneset.
- Rritja e inspektimeve (daljeve) rrjedh nga:
- Rritja e besimit të qytetarëve, evidentuar në +27 % më shumë thirrje në linjën komunale;

5. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PUNËS

Raporti i përmbledhur i punës së Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2025, është raporti i përmbledhur i punës i të gjithë sektorëve në drejtori dhe përfshin aktivitetet, veprimet dhe masat e inspektoratit komunal në zbatimin të ligjit, akteve nënligjore dhe planit të punës.

Performanca e inspektorëve sipas sektorëve gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025 në Drejtorinë e Inspeksionit.

Inspektor	Fushë	Procesverbal	Vendime	Gjobë
Abedin Pllana	Sherbime Publike	13	1	150 Euro
Aida Rushiti	Sherbime Publike	23	0	0
Arian Tahiri	Tregtar	2	0	0
Artan Abdurrahmani	Sherbime Publike	42	0	500 Euro
Lavdim Dobrev	Sherbime Publike	8	0	0
Flamur Mehaj	Ndërtimit	7	0	0
Kreshnik Abazi	Komunikacionit	0	0	0

Në ushtrimin e funksionit dhe autorizimeve, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore, Drejtoria e Inspeksionit konsideron se ka përmbushur Planin Vjetor të Punës të vitit 2025 për periudhën Janar-Qeshor.

1. Pasqyra tabelare

Nr.	Aktivitetet, masa dhe veprimet	Njësia
-----	--------------------------------	--------

1.	Inspektime me procesverbal	95
2.	Riinspektime	333
3.	Vizita dhe kontakte pune	600
4.	Aktvendime për eliminim të parregullsive	2
5.	Aktvendim për marrjen e pëlqimit për Taxi	0
6.	Aktvendime	212
7.	Vendime për ekzekutimin e akteve administrative	1
8.	Biznese të regjistruara për herë të pare	200
9.	Shuma e inkasuar nga gjobat me Rregullore Komunale	650.00 Euro
10.	Mjetet e inkasuara nga Komisioni për kushte minimale	650.00 Euro
11.	Vlera e produkteve të ndaluara	/
12.	Aplikime për pëlqime minimale-teknike	0
13.	Produktet të ndaluara nga shitja	Po
14.	Vlera e mallrave të asgjësuar	~15,000.00
15.	Kërkesa zyrtare	0
16.	Ankesa	1
17.	Gjobë administrative dhe mandatore	2
18.	Mbyllje e lokalit	/
19.	Vlera nga gjobat	650.00 Euro
20.	Shuma të inkasuara	650.00 Euro
21.	Shuma të pa inkasuara në procedurë	/
22.	Vlera e mallit të asgjësuar nga shitja	~15,000.00 Euro
23.	Inspektime të objekteve banesore-afariste	16
24.	Inspektime të objekteve banesore individuale	34
25.	Inspektime të objekteve afariste shumë banesore	16
26.	Kallëzime penale	1
27.	Lëndë në procedura tjera gjyqësore	20
28.	Leje për ndërtim nga DSHPI	/
29.	Leje Ndërtimore nga DPU	/
30.	Aktivizimi për rënien	/
31.	Lëndë në procedurë	/
32.	Lëndë të përmbaruara	95

RAPORT MBI AKTIVITETET E PËRBASHKËTA INSPEKTUESE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

I. HYRJE

Në përputhje me kompetencat e përcaktuara me:

- Ligjin nr. 03/L-040 për mbikëqyrjen inspektuese,
- Ligjin nr. 02/L-38 për inspektoratin sanitar,
- Ligjin nr. 03/L-049 për vetëqeverisjen lokale,
- Ligjin nr. 03/L-029 për tatimin mbi qarkullimin,
- Ligjin nr. 2004/18 për tregtinë,
- Ligjin nr. 08/L-067 për Inspektimet (i miratuar në qershor 2025),

- Udhëzimin Administrativ (VRK) nr. 01/2025 për përmbajtjen e procesverbalit të inspektimit,
- Rregulloren për funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm nr. 06/2022,
- Komuna e Mitrovicës Veriore, në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe me mbështetjen e Policisë së Kosovës, ka ndërmarrë një aksion të koordinuar inspektues me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, zbatimit të ligjshmërisë në aktivitetet afariste dhe mbrojtjes së pasurisë publike.

IV. PLOTËSIMI I KORNIZËS LIGJORE: LIGJI PËR INSPEKTIMET (08/L-067)

Ligji nr. 08/L-067 për Inspektimet, i hyrë në fuqi në qershor 2025, përcakton:

- Parimet e inspektimit (proporcionaliteti, transparenca, efikasiteti),
- Kompetencat e inspektorëve për kontroll, qasje dhe ndërhyrje,
- Procedurat e hartimit të procesverbaleve dhe urdhëresave,
- Detyrimet e subjekteve për bashkëpunim dhe zbatim të vendimeve.

Udhëzimi Administrativ VRK nr. 01/2025 përcakton:

- Formatin standard të procesverbalit,
- Elementet përshkimore dhe ligjore të çdo kontrolli,
- Afatet për paraqitjen e ankesave dhe përmbushjen e masave të vendosura.

Të gjitha procedurat e ndërmarra nga inspektorët komunalë kanë qenë **në përputhje me nenet 9, 14 dhe 27 të Ligjit 08/L-067** dhe udhëzimeve përkatëse.

V. KONKLUZIONE LIGJORE DHE REKOMANDIME

- Objektet pa kushte themelore sanitare, pa leje ndërtimi, ose të vendosura mbi prona të uzurpuara **nuk mund të legalizohen dhe nuk mund të kthehen në funksion afarist**;
- Mungesa e të drejtës juridike për veprimtari tregon shkelje të **Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Tregti dhe Ligjit për Tatimin mbi Qarkullimin**;
- Inspektorati ka vepruar konform dispozitave ligjore, dhe do të vazhdojë me kontroll të rregullt të zonave me rrezik të lartë.

VI. MASAT E PROPOZUARA

- Formimi i **një grupi të përhershëm ndërinstitutional** për menaxhimin e objekteve ilegale;
- Revizionimi i objekteve të përkohshme komerciale në pronë publike;
- **Asgjësimi administrativ i strukturave të paligjshme** që nuk kanë mundësi të legalizohen;
- Rritja e pranisë së inspektorëve sanitarë në zona me ndjeshmëri të lartë higjienike.

PËRFUNDIM

Raporti gjashtë mujor i Punës i Drejtorisë së Inspeksionit është dokument i rëndësishë së veçantë ngase ofron informacione të rëndësishme mbi punën, aktivitetin dhe angazhimin e kësaj drejtorie në zbatimin të ligjit, mbrojtje të rendit komunal si dhe mbrojtjen e interesit legjitim të Komunës së Mitrovicës dhe qytetarëve të saj. Në kuadër të ushtrimit të funksionit dhe mandatit ligjor, Drejtoria e Inspeksionit ka hasur në një varg vështirësish, siç janë ato të natyrës njerëzore po ashtu edhe teknike, të cilat janë tejkaluar me sukses, falë profesionalizimit dhe vullnetit të lartë të treguar nga menaxhmenti dhe stafi profesional i kësaj drejtorie.

- Të vazhdohet intensifikimi i aksioneve ndër-institucionale me fokus te siguria ushqimore;
- Të forcohet komponenta edukative për bizneset – deri në fund të vitit të mbahen së paku 3 workshop-e rajonale;
- Të adoptohet sistemi i ticketing-ut elektronik për gjobat, për të reduktuar proceset manuale.

Drejtorja e Inspeksionit, pavarësisht sfidave të kapaciteteve njerëzore dhe teknike, ka demonstruar performancë të qëndrueshme dhe ndikim të matshëm në rritjen e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Rekomandojmë që Kuvendi Komunal ta miratojë këtë raport dhe të mbështesë rialokimin e burimeve për zbatimin e rekomandimeve të lartpërmendura.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

AKTIVITETET KULTURORE/SPORTIVE

- Komuna e Mitrovicës Veriore ka shënuar 17 shkurtin ditën e Pavarsisë së Kosovës. Panairi i Trashëgimisë Kulturore "Vlera që na bashkon" i realizuar për herë të parë në këtë komunë, ishte një prej aktiviteteve kryesore që shënuan Ditën e Pavarësisë.
Ky aktivitet tre-ditor, i mbështetur nga Komuna e Mitrovicës Veriore në bashkëpunim me organizatën Business Women Mitrovica, ofroi një mundësi unike për vizitorët që të njihen me veshjet tradicionale kombëtare, ushqimet tipike dhe produkte të tjera kulturore që pasqyrojnë trashëgiminë dhe identitetin kombëtar.
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport zhvilloi aktivitet me nxënësit e shkollave fillore nga Mitrovica Veriore, të cilët kishin mundësinë të realizonin punime artistike me motive të lidhura me Ditën e Pavarësisë, duke kontribuar kështu në ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe historike të Kosovës. Punimet e fëmijëve u ekspozuan edhe gjatë panarit.
- Shënuam 8 marsin, organizuam darkën për stafin e komunës .
- Bashk me Kryetarin z.Atiq, morëm pjesë në homazhe përkujtimore në nderim të Avni Hajredinit.
- Se bashku me kryetarin dhe stafin e komunës kemi mbajtur homazhe në varrezat e dëshmorëve në Shipol.
- Më 22 Prill në Diën ndërkombëtare të Tokës, drejtoria jonë organizoi mbjelljen e fidaneve në hapësirat publike duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe promovimin e një qyteti të gjelbër.
- Më 23 Prill, në Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit, Komuna e Mitrovicës së Veriore përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i'u bashkua thirrjes globale për ta festuar fuqinë e fjalës së shkruar dhe rolin e librave në ndërtimin e shoqërive të dijes dhe mirëkuptimit.
Në shenjë simbolike të kësaj dite, shpërndamë libra për nxënësit e shkollave fillore "Aziz Sylejmani" dhe "Nonda Bulka".
- Nderuam dhe përkujtuam dëshmorët e lagjes së Kovaçëve.
- Si Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, me rastin e 26-vjetorit të të vlarëve dhe të pagjeturve në lagjen e Boshnjakëve, organizuam ceremoni përkujtimore dhe homazhe në "Shtëpinë Muze".
- Më 20 Maj u bë përrurimi i fushës sportive afër komunës, këtë fushë e financoi ProCredit Bank. Punimet përfunduan brenda afatit kohor të planifikuar sipas marrëveshjes. Gjithashtu u punua dhe u dorëzua raporti në ProCredit Bank.
- Gjatë muajit Maj, ndër rikthimin e shumë objekteve tjera, Komuna në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka rikthyer edhe sallën e sporteve. Njoftuam qytetarët dhe klubet sportive që salla sportive është funksionale dhe se nepërmas drejtorisë tonë mund të caktojnë terminet. Salla e basketbollit dhe fitnesit po shfrytëzohet nga të gjitha komunitetet pa dallim.
- Në përvjetorin e vrasjes së Haki Misinit, këngëtarit dhe anëtarit të grupit legjendar MAK, në ballkonin e hapur, brenda objektit të komunës, organizuam një aktivitet për të kujtuar jetën dhe veprën e tij, të shokëve e bashkëpunëtorëve të tij, artistëve të tjerë që u ndëshkuan mizorisht për artin e tyre – Mehmet Tupella dhe Esat Bicurri. Njëherit u promovua dokumentari "Nuk kam titull për artistët e vlarë", me regji të Dalmat Dobrës.
- Morëm pjesë në aktivitetin e parë në hapsirat e sallës së sporteve ku sportistët e jashtëzakonshëm të Boccias po zhvilluan stërvitjet intensive në kuadër të përgatitjeve për garën prestigjioze ndërkombëtare World Challenger – Astana 2025, që do të mbahet në fund të muajit gusht në Kazakistan. Pritëm kryetarin e klubit të Para Boccia të Kosovës, z.Murat Murati, i cili në shenjë falenderimi për mbështetjen ndaj klubit, ndau mirënjohje për Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

- Shënjuam shtëpinë e veprimtarit Latif Berisha në ditëlindjen e tij. Në përvjetorin e lindjes së veprimtarit dhe intelektualit të shquar Latif Berisha, vendosëm një pllakë përkujtimore në shtëpinë e tij familjare, e cila u dogj gjatë luftës, ndërsa ai vetë u vra në prag të saj.
- Se bashku me kryetarin, në nderim të ditëlindjes së Ukshin Hotit, vizituam shtëpinë muze në Krushë të Madhe.
- Bashk me kryetarin, në nderim të 45 civilëve të vrarë më 1999, ishim në Recak.

TAKIMET GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2025

- Takuam përfaqësuesen e organizatës joqeveritare znj. Melihate Beshiri, diskutuam për organizimin e Panairit Treditor për rastin e shënimit të datës së Pavarësisë.
- U takuam me mësimdhënëset e artit figurativ të shkollave “Aziz Sylejmani” dhe “Nonda Bulka, diskutuam për realizimin e një aktiviteti të përbaahkët me fëmijët e këtyre shkollave, edhe ky aktivitet gjithashtu për shënimin e datës së Pavarësisë së Kosovës.
- Në bashkëpunim me QRTK-Mitrovicë dhe Ministrinë e Kulturës për organizimin e pastrimit të Shtëpisë Muze me rastin e përkujtimit të masakrës dhe fillimin e procedurave për restaurimin e saj. U caktua takim i përbashkët më 21 Mars 2025.
- U mbajt takimi në Minsitrinë Për Kulturë, Rini dhe Sport. Të pranishëm në takim ishin znj. Jehona Shyti -Drejtoresh e Departamentit të Kulturës, z. Shehu- pronari i kompanisë kontraktuese si dhe Rrezarta Loxha- Drejtoresh e IKMM. Diskutuam për fillimin e procedurave, dorëzuam dokumentacionet kërkuara nga ne. gjithashtu palët propozuan dhe një takim me komunitet me që rast të kemi një vision sa më të qartë. Gjatë takimit secilit prej nesh i'u deleguan punët.
- Në vazhden e takimeve, në zyrat tona pritëm përfaqësuesit e OSBE-së. Ata na njoftuan për mënyrat se si mund të bashkëpunojmë. Ne para tyre prezantuam punën gjatë kësaj periudhe dhe kërkuam mbështetje në organizimin e eventeve dhe trajnimeve (për të cilat ata veçse na njoftuan).
- Takim tjetër ishte edhe takimi me Nur Damatin- Executive officer në EikOsovo, dhe me basketbollistin Musab Mala. Bashk me kryetarin z. Atiq dëgjuam propozimet e tyre në lidhje me një projekt tre vjeçar. Biseduam gjerësisht dhe u dakorduam të shikojmë mundësitë për mbështetje gjatë muajve në vijim.
- Gjithashtu, në takim pritëm edhe z. Burim Abrashi, kryetar i klubit të Pingpongut “Trepca”. Kërkesa e tij ishte mundësia e shfytëzimit të sallës së sporteve. Ne patjetër se u dakorduam që të gjitha përgatitjet e nevojshme të kryejn në hapsirat adekuate.
- U mbajt një takim me banorët e lagjes së boshnjakëve lidhur me restaurimin e shtëpisë-muze – simbol i historisë dhe identitetit lokal. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të kompanisë projektuese, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe QRTK-së Mitrovicë, u shkëmbyen ide, u kryen përgatitjet në terren dhe u paralajmërua prezantimi i draft-projektit brenda 10 ditëve të ardhshme. Draft-Projekti u prezantua pas afatit të caktuar, u aprovua dhe u lëshua vendimi për ndërhyrje në asetin “Muzeu i Viktimave”, në lagje Lumbardhi – Mitrovicë Veriore. Jemi në pritje që OE të na dërgojnë kopjet fizike të përcaktuara në vendimin (e bashkangjitur në email).
- Në maj të 2025, bashk me shefin e kabinit, z. Visar Syla, takim patëm edhe me z. Salvador Elmazi- Drejtor në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave. Biseduam rreth shiqimit të mundësive për hapjen e konkursit për punonjës në lidhje funksionalizimin e plotë dhe të qëndrueshëm të institucioneve kyçe publike: Palestrës Sportive dhe Bibliotekës së Qytetit.
- Gjatë kësaj periudhe, në zyrat e Caritas-Mitrovica u takuam me z. Boban Mirkovic dhe znj. Fitore Cimili për diskutim rreth renovimit të varrezave të komunitetit serb në Mitrovicën Jugore.
- Takim me përfaqësues të BE-së (znj. Helen Jakobos dhe z. Pleurat Kurti) për çështjen e palestrës dhe aksesit të komunitetit.

- Takim me përfaqësuesit e Katar Charity – Prishtinë për prezantim dhe dorëzim të projekteve tona.
- Takim me përfaqësues të BE-së (znj. Helen Jakobos dhe z. Pleurat Kurti) për çështjen e palestrës dhe aksesit të komunitetit.
- Takim me KFOR-in turk në objektin e Komunës për diskutim mbi projektet e dorëzuara dhe udhëzime për dokumentacionin shtesë, gjithashtu së bashku dolëm edhe në qytet për të parë hapsirat publike (të mundshme për ristrukturim për të cilat diksutoam gjatë takimit)
- Takim tjetër zhvilluam edhe me Save the Children në zyrat e tyre në veri. Njftuam ata për punëm që po bëhet në QPS, dhe kërkuam mbështetje për mbështetje të krijimit të një dhome për komunikim.
- Komunikuam dhe u takuam me përfaqësuesit e BKT-së, kërkuam nga ta mbështetje për renovimin e një fushe sportive. BKT pranuan propozimin tone, me email na njoftuan dhe pas përfundimit të rrugës do të fillojnë punimet.
- Në zyrat tona pritëm përfaqësuesit e DRC-së. Na shpalosën në pika të shkurta disa projekte që po mendojnë të realizojnë në veri, na njoftuan me anë të email-it se janë hapur procedurat e prokurimit për tre projekte që do të realizohen.

PJESËMARRJE NË TAKIMET (TRYEZA)

- Kemi marrur pjesë në trajnimin e organizuar nga OSBE- në Hotel Palace. Temat e trajnimit ishin: përmirësimi i shërbimeve publike, të drejtat e njeriut, kthim dhe komunitete.
- Sesioni informues -UNDP në lidhje me thirrjen e hapur për aplikim në programin ReLOaD3, ky session u mbajt në zyrat e AZHR-veri.
- Pjesëmarrjen në trajnimin dyditor për projekt buxhetin 2026-2028, organizuar nga Demos.
- Pjesëmarrje në trajnimin gjashtëditor që temë kishte bazat e administratës , nën organizimin të IKAP bashkë me komunën.

OBLIGIMET BRENDË INSTITUCIONIT

- Dorëzuam tek Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit modelin e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të për vitin 2025 dhe Planin Gjithëpërfshirës të Komunave për vitin 2024.
- U përpilua dhe dorëzua Raporti Vjetor 2024 dhe Plani i Punës për vitin 2025, si në formë fizike ashtu edhe elektronike.
- Puna në përpilimin e raporteve për aktivitetet e fëmijëve dhe panairin treditor.
- U punua dhe u dorëzua Qarkorja e Brendshme Komunale 2025-01

Informacione shtesë:

Hapsirat e aktiviteteve sportive janë siç vijon:
7.583 m²

Metrat katror për veprimtari të sportit (nën menaxhimin e komunës apo Qendrës Rinore) të shtuara gjatë vitit janë siç vijon:
2.830 m²

Numri i aktiviteteve të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal :

7 aktivitete gjithësej janë organizuar me buxhet komunal.

Disa foto nga eventet, aktivitet dhe takimet



Aktiviteti me rastin e ditës së librit



Aktiviteti me rastin e ditës së librit



Fusha e rinovuar nga ProCredit Bank



Aktiviteti me rastin e ditës së tokës



Ceremoni përkujtimore me rastin e 26 vjetorit të masakrës në lagjën e boshnjakëve



Aktiviteti me Federatën e ParaBocia



Paisja me mirënjohje nga Federata e ParaBocia për mbështetjen e sportistëve



Homazh në lagjen e Kovaçeve në nderim të martirëve të kombit



Eventi me rastin e përkujtimit të artistit Haki Misini



Eventi me rastin e përkujtimit të artistit Haki Misini



Pjesëmarrja në grupin punues,
organizuar nga Drejtoria për Siguri dhe
Emergjencë



Shënjimi i shtëpisë së veprimtarit Latif
Berisha



Takimi me banorët e lagjes dhe palët e
interesit në lidhje me restaurimin e
shtëpisë muze.



Homazh në nderim të ushtarit Avni
Koshtova



Foto nga takimi me Kforin Turk



Foto nga homazhi në varrezat e
dëshmorëve- Shipol



Foto nga Panairi treditör



Aktiviteti me nxënësit e veriut

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE GJEODEZI

Bazuar ne obligimet ligjore, bashkengjitur ne vijim gjeni Raportin e Punes per periudhen Janar-Qershor 2025.

1. Kërkesa të miratuara

- Leje ndërtimore	6
- Destinimi i tokës	2
- Restaurime/Renovime	13
- Leje rrënimi	1
- Shfrytëzimi i hapësirave dhe sipërfaqeve publike	39
- Te ndryshme	4

2. Rezultati nga të hyrat e realizuara

Në prezantimin e mëposhtëm do të pasqyrojmë të hyrat sipas klasifikimit të lartcekur për periudhën kohore **Janar – Qershor 2025**

1. Leje Ndërtimi.....	3,636.44€
2. Destinimi i tokës	00.00€
3. Restaurime/Renovime	00.00€
4. Leje rrënimi	120.32€
5. Shfrytëzimi i hapësirave dhe sipërfaqeve publike.....	11,293.05€
6. Te ndryshme	00.00€
Totali:	<u>15,049.81€</u>

Lëndë të përfunduara gjatë periudhës raportuese:

Bartje e Pronësisë/Posedimit- Blerje	44	Regjistrim i vërejtjes	1
Bartja e Pronësisë/Posedimit – Dhurim	16	Modifikimi attributeve të parceles	10
Bartja e Pronësisë/Posedimit-Në bazë të pranimi	39	Modifikimi attributeve të Ndërtesës/Pjesës së ndërtesës	6
Bartja e Pronësisë/Posedimit – Trashëgimia	15	Regjistrimi i hipotekës dhe Modifikimi i hipotekës	2

Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit 11	Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit 3
Ndarje / bashkim të parcelave 26	Regjistrimi i ndërtesës 10
Bartja e posedimit – Këmbim 1	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës 46
Bartja e Pronësisë/Posedimit - Ndarje fizike 3	Regjistrimi i ngarkesës tatimore 2
Modifikimi i të dhënave të personit 43	Koordinata 51
Fshirje e hipotekës 2	Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës 544
Krijimi i kopjes zyrtare të planit 305	Shërbimi i të dhënave – Vërtetim që nuk posedon pronë 314

DREJTORIA PËR SIGURI DHE EMERGJENCA

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia për periudhën Janar-Qershor 2025 aktivitetin e vet të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera **Nr.04/L-027**, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri **Nr.04/L-12**, Ligjin për Zjarrfikëje dhe Shpëtimit **Nr.04/L-049**, Udhëzimet Administrative, Rregulloren e organizimit të brendshëm të Komunës si dhe aktet tjera të cilat e rregullojnë këtë materje.

Ky raport përmbledhë punën e realizuar nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, në përputhje me planin gjashtëmujor të punës dhe kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Raporti ka për qëllim të paraqesë nivelin e zbatimit të aktivitetet e planifikuara, sfidat e hasura gjatë periudhës raportuese, si dhe rezultatet konkrete të arritura në fushat e sigurisë publike, menaxhimit të emergjencave dhe mbrojtjes civile.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia ka ndermarrë veprime të ndryshme në funksion të përforcimit të kapaciteteve për reagim ndaj situatave emergjente, bashkëpunimit me institucionet relevante dhe ngritjes së vetëdijes qytetare për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë. Raporti gjithashtu synon të identifikojë nevojat për përmirësimin dhe hapat e ardhshëm për periudhën pasuese.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia përveq detyrave të lartëpërmendura gjatë muajit Janar 2025 ka realizuar edhe këto detyra:

Nga ana e zyrtarëve të Drejtorisë është vizituar pellgu i lumit Ibër me qëllim të përcjelljes së ngritjes së nivelit të ujit apo dalja e lumit nga shtrati.

Pas emrimit të drejtorit të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia kemi vizituar Njësin Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. Me këtë rast drejtori është njoftuar me stafin e Njesisë si dhe problemet dhe kërkesat e tyre.

Me stafin e Drejtorisë kemi dalur në teren me qëllim të njohjes të kufijve administrative të Komunës dhe evidentimin e rreziqeve potenciale nga fatkeqësitë natyrore.

Kemi dalur në teren për visit edhe në Kodrën e Minatorëve.

Nga zyra e pranimit kemi pranuar dy kërkesa nga qytetarët edhe ate, një për rregullimin e shtëpisë së djegur, dhe një për intervenim në një podrum për shkak të vërrshimit të ujit, ku uji ka depërtu në podrum nga rregullimi i rrugës

➤ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit Shkurt 2025 ka realizuar këto detyra:

Nga ana e pjestarëve të Njesisë Zjarrfikëse është kontrolluar rrjeti i brendshëm dhe i jashtëm i rrjetit të hidrantëve në objektin e Komunës. Është rregulluar dhe funksionalizuar hidranti i jashtëm i cili gjindet përball hyrjes në objekt.

Kemi dalur në teren te Kroi i Vitakut me dhe Lagja e doktorëve me qëllim të vrojtimit të nivelit të prockës së ujit e cila rrjedh nga Kroi i Vitakut në drejtim të Lagjes së Doktorëve ku niveli i sajë ishte ngritur si pasojë e të rreshurave-shiut.

Nga data 18-27 03.2025 njëri nga Zyrtarët për Emergjencia për ka vijuar trajnimin IKAP në Qendrën për trajnime të Institutit të Kosovës për Administratë publike.

Takim me inspektorin e mbrojtjes nga zjarri lidhur me problematikën e këtij Inspektorati. Verifikimi I inspektimeve të objekteve lidhur me ndërmarrjen e masave parandaluese nga zjarri e tj.

Kemi dalë edhe disa herë gjatë muajit në teren.

➤ **Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit Mars 2025 ka realizuar këto detyra:**

Kemi qenë në vizitë në Komunën e Vushtrrisë përkatësisht në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Vizita kishte karakter pune rreth shkëmbimit të njohurive dhe përvojave të të dy drejtorive.

Jemi takuar me drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Menagjimit Emergjen në Prishtinë, Drejtorin e njoftova për problemet dhe kërkesat e Njesisë Zjarrfikëse, ku i njeiti na premtoj se do të na mbështes si dhe do të angazhohet për furnizimin me paisje dhe uniformë për pjeshtarët e Njesisë Profesionale të zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Me koordinatoren e Habitatit për Regionin e Mitrovicës jemi takuar në Komunë. Ai kërkoj nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca mbështetjen dhe vlerësimin e sigurisë së disa objekteve të cilat janë nën menaxhimin e Habitatit por që gjenden në teritorin e Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Kemi pasur takim me Komandantin e Njesisë Zjarrfikëse ku janë diskutuar problemet dhe kërkesat e tyre për paisje të ndryshme zjarrfikëse, për material higjienik e tj.

Gjatë kësaj jave kemi pasur edhe disa takime institucione tjera si me KRU ujësjellësi, Keds.

Zyrtarët për Emergjenca të cilët janë zyrtar në kaudër të Drejtorisë kanë dakur në teren dhe kanë evidentuar të gjitha shtëpijat të cilat janë të djegura dhe që paraqesin rrezik për njerëzit sidomos për fëmijët nga shembja e tyre.

Takim me Inspektorin e Parandalimit nga zjarri në lidhje me kategorizimin e objekteve në bazë të rrezikshmërisë nga zjarri.

Takim pune me drejtorin e Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca nga Komuna e Mitrovicës Jugore lidhur me ngritjen e bashkëpunimit në mes dy Komunave përkatësisht Drejtorive.

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca nga zyra për pranim ka pranuar tre kërkesa nga qytetarët.

Një kërkesë nga një banor për ndërtimin apo mbështetjen financiare për një mur mbrojtës me që rast i rrezikohej shtëpia nga shembja e dheut, një tjetër kërkesë për kompensimin e demit të pulave, ku një qenë i kishte dëmtuar një numër të pulave dhe një kërkesë për rregullimin e banesës për arsye të rrjedhjes së ujit nga kati i sipërm.

➤ **Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit Prill 2025 ka realizuar këto detyra:**

Vizitë në Stacionin Policor, ku arsyeja e vizitës ishte rritja e bashkëpunimit ndër institucional në fushën e sigurisë dhe Emergjenca në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Janë realizuar disa aktivitete me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e emergjencave dhe sigurisë publike.

Jemi takuar me zyrtarët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Vushtrrisë. Takimi kishte për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjell në fushën e emergjencave civile.

Takim me drejtorin e Ujësjellësit Regjional të Mitrovicës me qëllim të bashkëpunimit, u diskutua edhe për pjesëmarrjen e një anëtari nga Njësia e tyre në grupin punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal.

Janë realizuar takime me anëtarët e grupit punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal nga institucionet e ndryshme si nga KRU ujësjellësi, Elektro sever, Posta dhe disa nga anëtarët e grupit nga disa drejtori komunale.

Takim në Stacionin Policorë në Mitrovicën e Veriut lidhur me pjesmarrjen e një anëtarë në grupin punues si dhe lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional.

Zyrtari për Emergjencë i Drejtorisë së Siguri dhe Emergjencës ka marr pjesë të trajnimit dy ditor në qytetin e Pejës i cili është organizuar nga orkanizata Hervetes,, me fokus të veçantë në proqeset dhe rëndësia e dëgjimeve buxhetore në Komunat që përfaqësojnë.Trajnimit ka ofruar praktika dhe përvoja nga terreni për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe transparente në planifikimin buxhetot lokal.

Po ashtu është zhvilluar edhe një takim me komandantin e Policisë në Mitrovicën e Veriut, ku u diskutua rëndësia e koordinimit në rastet e situatave emergjente dhe forcimi i komunikimit të rregullt ndërmjet institucioneve përkatëse.Palët u pajtuan se vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë mund të garantohet siguria dhe mirëqenia e qytetarëve.

Kemi pasur një takim një vizitë në Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave përkatësisht në Departamentin e Parandalimit me qëllim të koordinimit ndërinstitucional për formimin e grupit punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal.

Kemi dalur në teren për të vërejtur pjesën e pellgut të lumit Ibër pas rreshjeve të shiut për të shikuar për ngritje eventuale të nivelit të ujit në lumin Ibër.

Gjatë këtijë muaji nuk kemi pasur asnjë kërkesë nga qytetarët e Komunës së Mitrovicës së Veriut.

➤ **Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit Maj 2025 ka realizuar këto detyra:**

Takim me drejtorin e Distriktit në Kompaninë KEDS në Mitrovicë.Qëllimi i takimit ishte diskutimi rreth formimit të grupit punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal. Si dhe mundësit e bashkëpunimit dhe ndihmës së KEDS-t në këtë drejtim.

Takim me Koordinatorin teknike të Post Telekomit të Kosovës poashtu rreth formimit të grupit punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal si dhe mundësit e bashkëpunimit me këtë kompani.

Gjithashtu është zhvilluar takimi me Drejtorin Operativ të Elektro Severit lidhur me formimin dhe bashkëpunimit me grupin punues dhe tema tjera.

Kontroll të Inspektorit për mbrojtje nga zjarri lidhur me zbatimin e masave parandakuse nga zjarri në objekte të qytetit të Mitrovicës së Veriut.

Kërkesa nga qytetarët nuk kemi pasur gjatë kësaj periudhe por jemi marr me punët e planifikuara të Drejtorisë.

➤ **Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit Qershor 2025 ka realizuar këto detyra:**

Në hapsirat e Komunës është mbajtur takimi i parë i grupit punues për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe Planit të Reagimit Emergjent Lokal. Në takim ishin present përfaqësuesit e disa drejtorive, përfaqësuesit nga Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave, ssi dhe institucioneve tjera si KRU Ujësjiellësi,KEDS, Njësia Zjarrfikëse, Policia e Kosovës, Kryqi i Kuq.

Takim pune në Komunën e Mitrovicës së Jugut me Drejtorin për Siguri dhe Emergjencë.Qëllimi i takimit ishte thellimi i bashkëpunimit në mes të dy drejtorive, sidomos tani kur priten të ngriten temperaturat dhe mundësia e shkaktimit të zjarreve është ma e madhe.

Gjatë muajit Qershor të këtij viti Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë ka pranuar disa kërkesa të qytetarëve për problemet e tyre si dhe ka pasur aktivitet në bazë të planifikimit të punës.

Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin e situatave emergjente dhe përmbushjes së misionit të saj parësor -mbrojtjes së jetës dhe pasurisë së qytetarëve, Njësia Zjarrfikëse ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të ngritjes së kapaciteteve operacionale dhe profesionale.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në mënyrë të vazhdueshme në ngritjen e nivelit të gatishmërisë së personelit përmes organizimit të trajnimeve, dhe ushtrimeve praktike. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e reagimit të shpejtë dhe të koordinuar në rastet e fatkeqësive natyrore, zjarreve apo emergjencave të tjera.

Në vazhdim po japim pasqyrën tabelare të intervenimeve të Njesisë Zjarrfikëse për periudhën Janar – Qershor 2025.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për periudhën kohore: **Janar - Qershor 2025**

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera Janar- Qershor 2025														
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknik e	Nr.i shërbimeve	Aksi dent e rrugore	Vershime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsajt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	7	4	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Shkurt	12	5	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12
Mars	23	14	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	23
Prill	18	7	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18
Maj	16	6	9	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	16
Qershor	22	11	10	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	22
Korrik														0
Gusht														0
Shtator														0
Tetor														0
Nëntor														0
Dhjetor														0
Gjithsejtë	98	47	49	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	98

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2025														
	LIOJI I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nënt.	Dhje.	GITHËS EJTË
1	ZJARRË	4	5	14	7	6	11							30
2	INTERVENIME TEKNIKE	3	7	9	11	9	10							30
3	SHËRBIME	0	0	0	0	1	1							0

[illegible]

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Qendra për punë sociale është zhvendosur në një lokacion tjetër, një ndërtesë pranë stacionit të autobusëve. Arsyeja e zhvendosjes është se ndërtesa e mëparshme nuk ishte në pronësi të komunës së Mitrovicës së Veriut, por ishte edhe një hapësirë e vogël për zyrtarët për të punuar.

Punëtorët e QPS-së refuzuan të punonin në lokacionin e ri dhe lanë punën e tyre; dokumentet dhe inventari u dorëzuan.

Pas kësaj, u shpall një konkurs për punëtorë të rinj. Ndërkohë, puna u krye nga punonjësja e komunës për çështje sociale, Turkana Tortos, me ndihmën e punëtores që ishte punësuar në konkursin para situatës, Erza Hyseni. Palët kishin një mirëkuptim për situatën e re dhe ishin në shërbim dhe ndihmë të të gjithë përdoruesve në çdo kohë.

Pas përfundimit të konkursit, u punësuan punëtorët dhe drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale. Drejtoresha e re është Edita Bilalli.

Në muajt e mëparshëm, u krye riaplikimi dhe kontrolli i përdorimit të shërbimeve sociale. Numri i viktimave të dhunës në familje është gjashtë.

Sa i përket kujdesit shëndetësor, ende nuk kemi bashkëpunim me spitalin dhe qendrën shëndetësore sepse ata refuzojnë çdo ndihmë dhe bashkëpunim.

Planifikimi për rinovimin e klinikës në “ Mikronaselje” është duke u zhvilluar.

Bazuar në kërkesën që paraqita, ministria formoi një komision vlerësimi me dy anëtarë të tjerë nga komuna e Mitrovicës së Veriut. Pas kësaj, do të kryhet një vlerësim i saktë i nevojës për ambulantën.

Në takimin në Ministri, u ra dakord që të financohet rinovimi i ambulantës, si dhe blerja e pajisjeve të reja.

Shërbimet e kësaj ambulante përdoren nga shqiptarët dhe serbët që jetojnë në atë vendbanim. Ajo është krijuar më shumë se 20 vjet më parë dhe që atëherë nuk ka pasur investime. Mitrovica Jugore ka juridiksion, dhe duke qenë se është në territorin e Mitrovicës Veriore, në një takim me drejtorin e shëndetësisë së Mitrovicës Jugore, Dr. Fahri Shabani, u ra dakord që ne ta marrim përsipër ambulantën, por së pari në konsultim me juristë dhe eprorë.

Në periudhën e kaluar, kam pasur takime me përfaqësues të KFOR-it dhe EULEX-it. Gjithashtu kam pasur biseda me qytetarët rreth problemeve të tyre dhe mundësive të mia për t'i ndihmuar ata.

Jam në dispozicion të tyre në çdo kohë.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

II. MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Misioni:

Qendra për Punë Sociale ka për mision të ofrojë shërbime profesionale dhe të specializuara sociale për individët, familjet dhe komunitetet në nevojë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave themelore të tyre dhe përmirësimit të mirëqenies sociale.

Përmes vlerësimit, ndërhyrjes dhe mbështetjes së vazhdueshme, QPS synon të kontribuojë në parandalimin dhe trajtimin e problemeve sociale, në promovimin e përfshirjes sociale dhe fuqizimin e grupeve të cënueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale.

- **Objektivat:**

Qendra për Punë Sociale, pasqyronë qëllimet kryesore të institucionit gjatë kësaj periudhe. Këto objektiva mund të ndahen në disa fusha, si mbrojtja e fëmijëve, shërbimet për të rriturit, bashkëpunimi ndërinstitucional, zhvillimi profesional i stafit, etj.

Objektivat e Qendrës për Punë Sociale (për periudhën **Shkurt-Qershor 2025**):

1. Ofrimi i shërbimeve efektive sociale për qytetarët në nevojë, përmes identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të rasteve sociale në përputhje me legjislacionin dhe praktikat profesionale.
2. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve, përfshirë parandalimin e dhunës, neglizhimit, abuzimit dhe ofrimin e ndërhyrjeve të duhura për sigurinë dhe mirëqenien e tyre.
3. Mbështetja e individëve dhe familjeve në rrezik social, përmes ndihmës psikologjike, këshillimit, referimit dhe bashkëpunimit me institucionet relevante.
4. Zbatimi i vendimeve gjyqësore dhe administrative, që lidhen me kujdestarinë, ndarjen e përgjegjësive prindërore, mbrojtjen e përkohshme dhe të përhershme, urdhrat mbrojtës etj.
5. Bashkëpunimi ndërinstitucional me gjykatat, prokurorinë, policinë, institucionet arsimore e shëndetësore, si dhe organizatat e shoqërisë civile, për menaxhimin e rasteve komplekse.
6. Zhvillimi profesional dhe ngritja e kapaciteteve të stafit, përmes pjesëmarrjes në trajnime, seminare dhe punëtori që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

III. Kategoria e Rasteve
Raport nga sektori i Shërbimeve Sociale

Nr.	Kategoria	Nr. i raste ve të reja	Numri i rasteve recidive	Numri i fëmijëve:	Të mitur dërguar ne <u>paraburgim</u> ose në <u>burg</u> <u>për të mitur</u> <u>në arrest</u> <u>shtëpiak</u> ose <u>SHEK</u>	Numri i shërbimeve të ofruara
				- Me prindër të ndarë		
				-Nën kujdestari		
				-Në strehim familjar		
1	Zgjidhje martese - Kërkesa	6				
2	Dhunë në familje	5				
3	Delikuenca e të miturve 14-18					
4	Fëmijë me sjellje asociale dhe në konflikt me ligjin nën 14 vj.	12	1			
5	Ngacmim seksual Dhune seksuale					
6	Fëmijë të dhënë në adoptim					
7	Kërkesa për kujdestari të aprovuara	1				
8	Kërkesa për strehim familjar të aprovuar te të afërmit					

	Kontrata:					
9	Kërkesë Panelit- DPSF për strehim familjar Kërkesë për aprovimin e Familjes strehuese	1				
10	Kërkesa për strehim familjar jashtë familjes Vizita:	1				
11	Të strehuar në Shtime- Lumbardhë, Fëmijë e të rritur, Vizita:					
12	Keqtrajtim i fëmijëve					
13	Kërkesa për bashkim Familjar					
14	Kërkesa për ndërrimin e emrit – mbiemrit					
15	Kërkesa për fëmijë me aftësi të kufizuar	6				
16	Rastet depressive -psikiatrike	1				
17	Rastet e trajtuara nga psikologu	2				
18	Fëmijë të braktisur					
19	Fëmijë të strehuar në SOS apo gjetkë Vizita:					
20	Kujdestaria për raste të veçanta					

21	Kërkesa për leje –trashëgimi					
22	Certifikata të ndryshme - për nënshtetësi - për zotësinë e veprimit Zotësi liruar nga pagesa - për ushtrimin e drejtës prindërore, etj.	4				
23	Kërkesa për heqjen e aftësisë së veprimit Propozim për marrjen e drejtës prindërore	2				
24	Pëlqimi për martesë të të miturve	1				
25	Viktima trafikimi –nr.					
26	Strehuar në Institucionin për mbrojtjen e fëmijëve potencial në trafikim –Lipjan ose në QMGF dhe MPVT					
27	Klientë të strehuar në Strehimore për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve (QMGF) Mitrovicë					
28	Kërkesa për të moshuarit për t'i strehuar në Shtëpitë e pleqve Plotësim shënimi zyrtar për persona të moshuar Refuzim i palës së moshuar					

	Raport Mjekësor laboratorik person i moshuar					
29	Të strehuar në OJQ –të tjera Hop and Hommes					
30	Kërkesa për adoptim të paaprovuara – në procedurë					
31	Kontaktet prindër -fëmijë	1				
32	Fëmijë i prindërve të penguar mbi ushtrimin e drejtës prindërore .					
33	Prezantimi në polici për intervistimin e të miturve	10				
34	Prezent në polici për dhunë familjare	1				
35	Prezent në Polici Abuzim seksual	1				
36	Njoftim-Raporte nga Policia Përgjigje në Kërkesë të Policisë Asistim sipas kërkesës së Policisë në rastet e fëmijëve në situatë rruge	12				
37	Prezantimi në seancë gjyqësore për konflikte martesore:	11				

	Raporte dedikuara për gjykatë:	5				
	Shkresa nga Gjykata:					
	Thirrje nga Gjykata për vërtetimin e atësisë:	1				
	Aktvendim nga Gjykata					
38	Prezantimi në seancë gjyqësore për adoptim					
39	Prezantimi në seancë gjyqësore për të mitur delikente: Prezenca në Prokurori: Shkresa nga Prokuroria Aktvendim nga Prokuroria Raport dedikuar Prokurorisë	11				
40	Prezantimi në seancë gjyqësore për dhune seksuale					
41	Prezantimi në seancë gjyqësore për trafikim					
42	Vizita familjeve për rastet aktive (pa marr parasysh se cila kategori)	10				
43	Vizita në shkollë për të mitur					
44	Raste tjera –shëno: kërkim lëmoshë Rastet për TMR					

45	Prezent gjatë Ekzaminimit- Forenzik për fëmijët nën moshën 18 vjeçare					
46	Ndihmë e drejtpërdrejtë nga organizata TDH					
47	Regjistrimi i mëvonshëm për të mitur	1				
48	Dhunim ndaj te miturve					
49	Bashkësi jashtëmartesorë me persona nën moshën 16 vjeçar	1				
50	Vizita konsultime në DPSF					
51	Kërkesa dhe njoftime nga QPS					
52	Sesione këshilluese të ndryshme Sanimi i marrëdhënieve familjare:	23				
53	Lëndë të proceduara në bazën e të dhënave	17				
54	Raport javor për DIEMS					
55	Kërkesë nga Shërbimi Korrektues i Republikës së Kosovës					
56	Qasje në dokumentacion					
57	Vizita në Institutin Shtime					
58	Vizita në Shtëpi për përkujdesje të personave të moshuar					

	Kërkesë për vazhdimin e qëndrimit ne Skenderaj: Kërkesë për strehim nga klientët e moshuar dhe pa përkujdesje familjare : Njoftim nga SHPMPF Vendim për vendosje në SHPMPF					
59	Plotësim shënimi zyrtar për fëmije me aftësi të kufizuara Shpërndarje lëndëve të Komisionit Mjekësor në mënyrë proporcionale: Pranim Ankese nga personat me aftësi të kufizuara :					
60	Kërkesë për mendim profesional DAKPM/DPSF Kërkesë nga Karitasi					
61	Kërkesa për vazhdim të kontratave ne ISHM- Shtime Transfer i rezidentit nga Shtime në Lummadh					
62	Njoftim nga QKUK –KOGJ Asistim sipas kërkesës së KOGJ					
63	Përdorues i substancave narkotike					

64	Intervenimet te përgjithshme raste aktive dhe raste te reja					
65	Kërkesa nga SOS Fshati					
66.	Njoftim nga Policia për kanosje					
67.	Njoftim nga QMGF si person i Zhdukur Njoftim nga QMGF					
68.	Konsulta DPSF Raport për DPSF Konsulta me institucione të tjera : Kërkesa nga DPSF Përgjigje DPSF/MFPT Vizita në QMGF					
69.	Referim i të miturve tek psikologu raste aktive	2				
70.	Transfer i lëndëve tek QPS në nivel vendi Përgjigje nga OFAP-i Përgjigje QPS-ve Kërkesa nga QPS në nivel vendi	5				
71.	Kërkesa nga QSHM Përgjigje QSHM-së					

72.	Konsulta me familje strehuese lidhur me fëmijën A.O Konsulta me familjen strehuese G.I					
73.	Kërkesa nga Institucionet Komunale					
74.	Ankesë drejtuar sektorit të Shërbimeve Sociale Kërkesë Shërbimeve Sociale					
75.	Tjera					
TOTALI SIPAS KATEGORIVE						154

RAPORTI NGA SEKTORI I ASISTENCËS SOCIALE

Kërkesa të reja
25

Lëndë të ri- aplikuara mujore	Të ndërprera pasi fëmija ka mbushur 5 vite	Lëndët e refuzuar nga K.M	Të ndërprer a	Vërteti m që merr ndihma sociale	Vërtetim që nuk merr ndihma sociale	Numri i rasteve të ndërprera me ATK	Ankesë drejtua r SNS-së	Përgjigj e për DMS
157	4	12	34	7	7	11	21	

Dërgim i lëndës në kopje të vendimit dhe formularë në original pasi pala ka ushtruar padi	Lëndë të ri- aktivizua ra	Lëndë të ndërprera pasi që janë identifikuar si të papërgjegjshme	Lëndë me ankesë të refuzuara nga shkalla e dytë si e pabazuar.	Vendim i Gjykatë për kthim në Skemën e	Lëndë Inicimi në Gjykatë për	Vendim i Gjykatës për kthim në Skemën e
---	------------------------------------	---	---	--	--	---

		falë punës së menaxherit të rastit.		ndihmave Sociale rasti R.I	kthimin e mjeteve pa meritë	Ndihmave Sociale
	2		4			

RAPORTI NGA SHERBIMI PER PROTOKOL, VULE DHE ARKIVE

Shkresa nga Gjykata Themelore në Mitrovicë	14
Shkresa nga Prokuroria	
Procesverbal nga Polica	6
Kërkesa Dërgesa	2
DPSF/MFPT	
Njoftim QMGF „Raba Voca “	
Kërkesa të QPS-ve në nivel vendi	1
Kërkesë për vazhdimin e qëndrimit të fëmijëve në Shtime	
Përgjigje nga QPS-Prishtinë	1
Kërkesa nga Institucionet komunale	
Kërkesë për vendosje të personave të moshuar	
Kërkesë realizim kontakti	
Kërkesë për Vërtetim mbi kryerjen e praktikës	
Kërkesë nga DMS	
Kërkesë nga SOS – Fshati për pëlqim	
Dhënie pëlqimi sipas kërkesës së SOS –it	
Kërkesë nga QSHM - Mitrovicë	
Kerkesë për transfero lënde fëmijë me aftësi të kufizuara	
Vertetim mbi ushtrimin e drejtës Prindërore	
Kërkesa për mbështetje drejtuar organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve	

Njoftim Policor			
Raporte për palët			
Kërkesë nga palët			
Raport dërguar Gjykatave Themelore në nivel vendi			4
Raport dedikuar Gjendjes Civile në Prishtinë			
Përgjigje QMGF „Raba Voca“			
Raport DMS			
Raport DPSF/MFPT			
Vërtetim mbi ushtrimin e drejtës prindërore			
Raport i Komisionit Mjekësor			
Kërkesë për mbështetje të fëmijës			
Procesverbal nga Policia dërguar QPS –ve në nivel vendi			
Raporte për Gjykatën Themelore			
Ankesa drejtuar sektorit Skemës së ndihmave Sociale			12
Kërkesa për fëmijë me aftësi të kufizuara			5
Ankesa drejtuar sektorit të Shërbimeve Sociale			
Njoftim nga Gjykatat Themelore në nivel vendi			
Vërtetime	Me pagesë	Liruar nga pagesa	Gjithsej
Vërtetim që nuk i është marr zotësia e veprimit		4	4
Vërtetim për leje trashëgimie			
Vërtetim për lirim nga shtetësia			
Vërtetim që nuk janë përfitues të skemës sociale		10	10
Vërtetim që janë përfitues të skemës sociale		14	14
Totali i të hyrave vetanake të QPS-së			0

Shënim: Statistikat janë të bazuara në regjistrat zyrtarë dhe evidencat nga sistemi elektronik i menaxhimit të rasteve.

IV. AKTIVITETET KRYESORE TË REALIZUARA

- Realizimi i vizitave në terren për identifikimin e rasteve sociale
- Hartimi i planeve individuale të intervenimit social

- Bashkëpunimi me institucionet partnere (Policia, Gjykatat, Drejtoria e Arsimit, Shëndetësia, OJQ-të)
- Mbështetje për rastet në procedurë gjyqësore
- Mbështetje për viktimat e dhunës për ndihmë psiko-sociale
- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere në bashkësi (Dita Botërore e Fëmijëve, Dhuna në Familje etj.)

V. SFIDAT E HASURA

- Nevoja për automjete për vizita në terren
- Kapacitete të kufizuara për strehim urgjent
- Mungesa e trajnimeve të specializuara për punonjësit

VI. REKOMANDIME PËR PERIUDHËN VIJUESE

- Zgjerimi i stafit profesional me punonjës socialë
- Sigurimi i buxhetit për nevoja emergjente të rasteve sociale
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe pajisjeve teknike
- Organizimi i trajnimeve të avancuara për stafin
- Ngritja e bashkëpunimit institucional dhe krijimi i mekanizmave të përbashkët për mbrojtjen e fëmijëve dhe viktimave të dhunës

VII. KONKLUZION

Gjatë periudhës Shkurt- Qershor 2025, Qendra për Punë Sociale ka realizuar me përkushtim detyrat dhe përgjegjësitë e saj ligjore dhe profesionale në shërbim të qytetarëve dhe komunitetit. Përmes angazhimit të stafit multidisiplinar dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucionet relevante, janë menaxhuar një numër i konsiderueshëm rastesh sociale, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve, ndihmën për familjet në nevojë dhe përkrahjen e individëve në situata të vështira sociale.

Megjithëse janë evidentuar sfida të ndryshme në aspektin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale, Qendra ka arritur të mbajë standardin e ofrimit të shërbimeve bazuar në parimet e profesionalizmit, konfidencialitetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Rekomandohet që për periudhën në vijim të vazhdohet me përforsimin e kapaciteteve të stafit, rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore, me qëllim ofrimin sa më cilësor dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve për të gjitha kategoritë e qytetarëve që kërkojnë mbështetje nga Qendra për Punë Sociale.

DREJTORIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) funksionojnë në të gjitha komunat në territorin e Kosovës. Në Mitrovicë, pas miratimit të Rregullores 2010/2, zyra me bashkimin e zyrës për komunitete dhe zyrës për kthim, u emërua Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), ndërsa me vendim të kryetarit të komunës së Mitrovicës Veriore, nga muaji Maj 2023, funksionojmë në nivel të drejtorisë.

Demografia e komuniteteve jo shumicë në komunën e Mitrovicës Veriore, nuk dihet saktë pasi që regjistrimi i fundit i popullësisë në vitin 2011, në qytetin e Mitrovicës Veriore nuk është realizuar fare. Andaj të dhënat tona i bazojmë në raportet e organizatave ndërkombëtare sic është ai i OSCE “Municipal Profiles” në vitin 2018. Sipas të cilit në komunën e Mitrovicës Veriore banojnë 29,460 banorë. Sipas përbërjes etnike në komunën e Mitrovicës Veriore, banojnë 22.530 Sërb, 4900 Shqiptar, 1000 Boshnjak, 580 Goran, 210 Turk, 200 Rom, 40 Ashkali. Drejtoria për Komunitet Lokale dhe Kthim, ka përfshirje ndëretnike ngase stafi i saj përbëhet nga Egjiptian, Sërbë dhe Boshnjak. Drejtoria gjithashtu realizon takime periodike me përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në Komunë nëse paraqitet ndonjë problem dhe përpiqet t'i ndihmojë ata. Në rastet kur drejtoria nuk mund të ndihmojë, ne i drejtohem Shërbimeve të ndryshme Komunale për ndihmë (në varësi të problemit), ose i referojmë njerëzit në OJQ të ndryshme ose organizata ndërkombëtare që mund të ofrojnë ndihmën e duhur. Gjithashtu, ne koordinohemi me institucionet shtetërore, ministri të ndryshme, Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës etj. në mënyrë që të arrihet zgjidhja më e mirë dhe të zgjidhen problemet e komuniteteve në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kthimi:

- Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe shtete të regjionit Serbi, Mali të Zi, Maqedoni
- Procesi për regjistrimin e personave-familjeve në kuadër të aktiviteteve për riintegrimin e personave të riatedhesuar
- Të ndryshme: trajnime, seminare, vizita të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare
- Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe shtete të regjionit Serbi, Mali të Zi, Maqedoni

Sa i përket kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur (periudha ,viti 1998/99 dhe 2004) brenda vendit dhe shtete të regjionit, kryesisht Serbi, Mali të Zi dhe Maqedonin Veriore hynë në kuadër të detyrave dhe obligimeve primare të drejtorisë komunale për komunitete dhe kthim nuk ka pasur kërkesa për kthim.

Pjesa më e madhe e komuniteteve romë, ashkalijë, janë të kthyer në pronat e tyre në Jug të qytetit gjatë viteve 2007-2010, të cilëve u janë ndërtuar shtëpitë me ndihmën e Komunës së Jugut ,përmes alokimit të tokës (mbi 10 hektar toke) dhe mbështetje financiare të organizatave ndërkombëtare .Në 3 muajorin e parë 2024, nuk kemi pasur të kthyer në mënyrë të organizuar apo përmes ndonjë organizate vendore apo ndërkombëtare. Mu për këtë fakt edhe nuk kemi të dhëna e as ndonjë kërkesë për kthim të komuniteteve të lartcekura e të cilat kërkesa, sidomos të komuniteteve romë, ashkalijë, egjiptian , personave të zhvendosur në shtete të regjionit sidomos nga Mali i Zi dhe Serbi.

Mund të ketë ndonjë rast, kthim spontan të paorganizuar i komuniteteve Romë, Ashkalijë, e të cilët nuk lajmërohen tek ne zyrtarisht për evidentim, ndërsa numri i të kthyerve të komunitetit shqiptar në pjesën veriore, në këtë periudhë raportuese është i vogël.

Regjistrimi i rasteve ,riintegrimi i personave të riatdhesuar

Edhe gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 në këtë periudhë kohore nuk ka pasur të kthyer nga shtete Europiane , andaj edhe me pake raste, kërkesa të paraqitura në zyrat tona. Në departamentin për kthim dhe riatdhesim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme,kemi kërkuar akses në sistemin e menagjimit të rasteve. Gjithashtu jemi në pritje të ftesës së mbajtjes së trajnimit të zyrtarëve të drejtorisë rreth funksionimit të sistemit të menagjimit të rasteve. Komisioni Komunal për Ri-integrim/KKR/ gjatë periudhës kohore Janar- Mars, për shkak të mungesës së personelit adekuat,e profesional nuk është krijuar. Në aspektin e përgaditjes sa më të mirë dhe me profesionale në drejtim të realizimit sa më me sukses të Strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregullores në fuqi, gjerë më tani jemi në pritje për të mbajtur disa trajnime dhe disa takime në nivelin qendror perkatesisht në MPB- Departamenti e riatdhesimit.

- Të Ndryshme

Në këtë periudhë Janar- Qershor 2025 kemi pasur aktivitete të ndryshme me OJQ-te vendore apo nderkombetare, trajnime dhe punëtori të organizuara. Bëjnë të madhe paraqet buxheti shumë i vogël i ndarë për drejtorinë tona apo me mirë të themi se ky buxhet nuk mbulon as nevojat elementare për disa raste, kur kësaj i shtohen edhe rastet e riatdhesimit sidomos për rastet pas kalimit të njeveqarit për akomodim të personave të riatdhesuar e që Komunën e obligon edhe Ligji për Veteqeverisje lokale dhe Ligji mbi financimin e veçant të banimit që këtyre personave të cilët nuk kanë ku të banojnë tu ndihmohet me pagesë të qirase.

Projektet - në terren për komunitetet dhe përfituesit e tyre dhe bashkëpunimi me palët e interesuara - aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut:

-Në periudhën Janar- Qershor 2025, Drejtoria Komunale për Komunitete dhe Kthim ka mbajtur disa takime krahas kryerjes së detyrave aktuale, të cilat janë pjesë përbërëse e punës së zyrës, të gjitha me qëllim të përmbushjes së detyrave që janë obligim i drejtorisë.

- Gjatë muajit Janar- Shkurt , asistuaam pjestarë të komuniteteve jo shumicë për të aplikuar në thirrjen publike të MAPL-së për ndërtimin e shtëpive. Gjithashtu realizuam vizita për të informuar rreth kësaj thirrje publike, për rezultatet e të cilës jemi në pritje. Ndërsa nga thirrje publike e kaluar janë 7 pjestarë të komuniteteve jo shumicë.

-Në muajin janar patëm një takim me zyrtarët e Drejtorisë në të cilin është bërë Finalizimi i planit të punës 2025.

- Nga drejtori dhe stafi i Drejtorisë janë realizuar Takime me pjestarë të komunitetit Rom dhe komuniteteve të tjera.

- Vizita në teren për diskutime të drejtpërdrejta me qytetarë, pritja e palëve në zyrë për lehtësimin e casjes në shërbime publike.

-Pjesëmarrja në panelin “Dialogu nderetnik dhe kohezioni social, fuqizimi i grave, pakicave dhe të rinjëve për pajtim në Kosovë.

- Pjesëmarrja në eventin permbylles të projektit “ Ofrimi i shërbimeve pavarësues për personat me aftësi të kufizuara dhe pjestareve të komuniteteve jo shumicë”.

- Organizimi i sesionit per grate e komuniteteve jo shumice me temen “ Barazia Gjinore dhe mos diskriminimi në bashkëpunim me zyrën për barazi gjinore.
- Pjesëmarrja ne kampin verore “ HARMONY TALKS” te organizuar nga organizata ADRC ne partneritet me organizatën joqeveritare REC, te financuar nga UNDP dhe Bashkimi Evropian. Me kete rast te rinje dhe te reja kishin mundesine qe te shkembejne pervoja, te socializohen me njeri tjetrin dhe ne fund te dalin me disa ide qe do te financohen nga REC dhe ADRC. Realizimi i disa aktiviteteve rinore do te perfshijë edhe qytetin e Mitrovicës Veriore.
- Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë, Qendra Rajonale në Mitrovicë organizoi punëtorinë "Trajnim për përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe anëtarët e këshillave komunale të sigurisë për parandalimin e incidenteve të sigurisë", ku morën pjesë punonjësit e Drejtorisë.
- Në këtë periudhë janë mbajtur disa mbledhje të Komitetit për Komunitete, por drejtorja jonë nuk është ftuar të marrë pjesë në këto takime, për të bashkëpunuar apo raportuar.
- Propozim per formimin e grupit punues per hartimin e PLANI I VEPRIMIT PER INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI 2023-2027
- Pjesëmarrja ne eventin e projektit “Harmony Talks”
- Pjesëmarrja ne fokusgrup nga organizata SIT
- Debatimi me studentet nga komunitete te ndryshme ne regjionin e Mitrovices
- Takim me organizaten “ Mitrovica Women Association For Human Rights”
- Promovimi i mbeshtetjes se arsimit te komuniteteve ne pakice numerike organizua nga OSCE
- Tri takime te grupit punues per hartimin e Planit te veprimit per avancimin e te drejtave te komuniteteve Rom dhe Ashkali 2024-2026
- Draf Planit i Veprimit per Avancimin e te drejtave te Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2024-2026
- Takim me UNHCR dhe Advancing Together per situaten e komuniteteve dhe riatdhesimin
- Takim pune me Jennifer Bell, Grese Lamallari, Visar Ymeri, Andreas Katsouris per te diskutuar per gjendjen e romeve, ashkalive dhe egjiptianeve ne Mitrovice.
- Pritja e paleve ne zyre dhe keshilli per ceshtje te ndryshme
- Takime dhe vizita ne teren per te diskutuar me qytetare sa i perket te drejtave dhe lirive themelore dhe mosdiskriminimit
- Shperndarja e veshmbathjeve per femijet e komuniteteve Rom dhe Ashkali ne bashkepunim me Kryqin e Kuq.
- Pjesëmarrja në tryeza dhe panele nga organizatave të shoqërisë civile
- Takim pune në mes të ekzekutivit të komunës dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës z.Albin Kurti dhe ministrave Elbert Krasniqi dhe Nenad Rashic.
- Pjesëmarrja në tryezën e përbashkët në mes të Kryeministrit Albin Kurti dhe ZKKK-të nga të gjitha komunitetet e Kosovës
- Pjesëmarrja në kampin vjeshtor me të rinjtë e komuniteteve nga rajoni i Mitrovicës me temën menagjimi i konflikteve.
- Asistimi i palëve për aplikime në thirrjet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Pjesëmarrja në aktivitetet kulturo artistike
- Takim pune me zyrtarët e OSCE të cilet kërkuar prespektivën e komuniteteve jo shumicë për hapjen e dy urave të reja mbi lumin Ibër. Thëksova se urat janë për bashkëpunim e bashkim, e kurrësesi për probleme e rrezikimin e sigurisë së ndonjëri komunitet. Urat lehtësojnë lëvizjen Veri-Jug në mënyrë më të shpejtë dhe të lehtë për të gjithë qytetarët e Mitrovicës, pa dallime të përkatësisë etnike.
- Partniriteti me organizatën për migracion IOM në projektin e financuar nga BE që synon fuqizimin ekonomik dhe zhvillimin e qendrueshëm. Në komunën tonë 3 biznese kanë përfituar

mjete të ndryshme për të zhvilluar veprimtarinë e tyre. Këta 3 përfitues janë: 1 Shqiptar, në vlerë 3,300.00 € 1 Sërb në vlerë 4,150.00€ dhe 1 Boshnjake në vlerë prej 3,295.00€

Planifikimi dhe buxheti i zyrës

Para planifikimit të buxhetit për vitin 2025, nga drejtoria e financave na janë dhënë udhëzime sipas të cilave duhet të planifikojmë buxhetin, dhe i njëjti është planifikuar dhe miratuar. Sipas buxhetit për vitin 2025, për DKKK-në janë paraparë 500 euro nga mjetet për mallra dhe shërbime. Në tremujorin e parë të vitit aktual janë zhvilluar shumë vizita në terren. Në zyrën pritëse kanë marrë mjaftueshëm kërkesa për ndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në gjendje jo të mirë financiare. Pas një vizite në terren dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesave kemi përzgjedhur familjet përfituese të ndarjes së ndihmave. Shpërndarja ende nuk është kryer për shkak se nuk është kompletuar ende dokumentacioni i plotë i tenderit nga shërbimi i prokurimit, kështu që paket do t'u shpërndahen familjeve në tremujorin e dytë të këtij viti.

Çështje ose aktivitete të tjera

Së fundi me kërkesën e Kryetarit të Komunës z. Erden Atiq, është hapur konkursi për pranimin e 5 zyrtarëve në drejtorinë tonë. Lidhur me këtë së shpejti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit të njëjtit do të fillojnë punën e tyre dhe me këtë drejtoria do jetë më e plotë për kryerjen e detyrave të saj.

RAPORT NARRATIV I PERFORMANCËS

Drejtoria për Komunitete Lokale dhe Kthim dhe Marrëdhënie me Publikun

Komuna: Mitrovicë Veriore

Periudha: Janar – Qershor 2025

FUSHA 13 – PËRFAQËSIMI GJINOR DHE BARAZIA NË SHËRBIME

Treguesit përkatës: 13.1.2, 13.1.4, 13.2.1

Është organizuar sesion për gratë e komuniteteve jo-shumicë me temën “Barazia Gjinore dhe Mosdiskriminimi” në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore (treguesi 13.2.1 – aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit).

Drejtoria përfshin staf me përfaqësim ndërkomunitar (Shqiptar, Egjiptianë, Serbë dhe Boshnjakë), duke kontribuar në barazinë në përfaqësim dhe në përfshirje të drejtë gjinore e etnike.

FUSHA 3 – LLOGARIDHËNIA DHE PËRFSHIRJA PUBLIKE

Treguesit përkatës: 3.1.1, 3.2.2

Është mundësuar pjesëmarrja e komuniteteve në aktivitete të ndryshme, panele publike, debate rinore dhe takime me komunitetet në terren – duke rritur përfshirjen dhe komunikimin e ndërsjellë.

Janë pritur qytetarët në zyrë për të adresuar kërkesa dhe probleme të ndryshme, veçanërisht në qasje në shërbime – duke reflektuar përmbushje të treguesit 3.1.1 mbi konsultimet dhe dëgjimet me qytetarë.

FUSHA 12 – MBROJTJA E MJEDISIT DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Tregues përkatës: 12.2.3, 12.1.2

Në partneritet me IOM dhe BE, është realizuar një projekt që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm përmes financimit të 3 bizneseve të komuniteteve të ndryshme – duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe ambienta lokal (tregues 12.2.3 – integrimi i zhvillimit ekonomik me planifikim mjedisor).

FUSHA 16 – ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Tregues përkatës: 16.1.1, 16.2.1

Përmes bashkëpunimit me IOM dhe BE janë ndihmuar 3 biznese (Shqiptar, Serb, Boshnjak) – konform treguesit për përkrahjen e NVM-ve dhe përkrahjes ndërkomunitare për zhvillim ekonomik.

Janë asistuar qytetarët për aplikim në thirrje publike të MAPL dhe MKK për ndërtim banesash dhe ndihmë ekonomike – përmbush treguesin mbi mbështetjen për përfshirje të komuniteteve në thirrje publike.

FUSHA 15 – KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR / RIATDHESIM

Tregues përkatës: 15.2.2, 15.3.1

Gjatë periudhës nuk ka pasur raste të riatdhesimit të organizuar nga shtetet e BE-së. Po ashtu, për mungesë të stafit nuk është funksionalizuar Komisioni Komunal për Ri-integrim (KKR).

Janë kërkuar trajnime nga MPB për sistemin e menaxhimit të rasteve – në përputhje me treguesin për përgatitjen institucionale për riatdhesim.

FUSHA 1 – SHËRBITET PUBLIKE ADMINISTRATIVE

Tregues përkatës: 1.1.1, 1.1.2, 1.1.3

Drejtoria ka ofruar shërbime për qytetarë në formë të pritjes në zyrë dhe mbështetje në dokumentacion – në linjë me treguesit për trajtim të kërkesave administrative.

Shërbimet janë lehtësuar përmes komunikimit direkt me qytetarët, sidomos të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes vizitave në terren dhe ndihmës për aplikim në skemat komunale dhe shtetërore.

FUSHA 14 – ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Tregues përkatës: 14.4.3

Drejtoria ka marrë pjesë në promovimin e mbështetjes së arsimit për komunitetet në pakicë numerike, aktivitet i organizuar nga OSBE – në përputhje me treguesin mbi ndërgjegjësimin për përfshirjen në arsim.

FUSHA 5 – KULTURË, RINI DHE SPORT

Tregues përkatës: 5.1.1, 5.2.1

Janë realizuar aktivitete për të rinjtë në kuadër të kampeve verore dhe vjeshtore “Harmony Talks”, si dhe aktivitete ndërgjegjësuere kulturore – duke adresuar fuqizimin e të rinjve nga komunitetet në linjë me treguesit për përfshirje në aktivitete rinore e kulturore.

FUSHA 2 – TRANSPARENCA KOMUNALE

Tregues përkatës: 2.1.1, 2.1.3

Në raport nuk evidentohet në mënyrë të qartë pjesëmarrja në publikime online të mbledhjeve të Kuvendit Komunal apo qasja në dokumente publike – rekomandohet rritja e dokumentimit të aktiviteteve në ueb-faqen e komunës, siç kërkohet nga treguesit e kësaj fushe.

PLANIFIKIMI DHE BUXHETIMI (Tregues ndërfushor)

Buxheti për vitin 2025 për Drejtorinë është miratuar me vetëm 500€ për mallra dhe shërbime , shumë e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e vazhdueshme të komuniteteve. Vonesat në realizimin e ndihmave për shkak të mungesës së mjeteve ose vonesave procedurale janë evidentuar si pengesë.

Është hapur konkurs për 5 zyrtarë të rinj, që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve të zyrës.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM NË BAZË TË SMPK

Të sigurohet funksionalizimi i Komisionit Komunal për Ri-integrim.

Të rritet dokumentimi dhe publikimi i aktiviteteve në platformat zyrtare të komunës.

Të sigurohet përfshirje sistematike në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

Të zhvillohen mekanizma për regjistrimin e kthimeve spontane (tregues 15.2.2).

Të forcohet raportimi për përfaqësimin gjinor dhe ndërkomunitar në nivel vendimmarrës.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE MBROJTJES SË MJEDISIT DHE PYJEVE

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka filluar së fundmi funksionimin, saktësisht me datë 24.03.2025 dhe është në fazën fillestare të organizimit të punës.

Aktualisht, Drejtoria funksionon me një zyrtar dhe jemi në fazën e rekrutimit të një zyrtari të dytë i cili do të jetë në pozitën Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave.

Drejtoria nuk ka një buxhet të ndarë për zhvillimin e aktiviteteve apo zbatimin e projekteve bujqësore.

Buxheti për vitin aktual është i dedikuar vetëm për pagat e stafit.

Si Drejtori kemi disa objektiva, konkretisht për bashkëpunim me fermerët lokal, edhe pse kjo është një sfidë në vete, pasi që ende nuk kemi numër të saktë se sa fermerë operojnë gjithsej në Komunën e Mitrovicës Veriore. Më pas, përgatitjen e një **plani për subvencionimin e serave të tipit tunel**, motokultivator me paisje përcjellëse, koshere të bletëve duke u mbështetur kështu, në nevojat reale të fermerëve. Hartimi i një **strategjie për zhvillimin rural dhe ruajtjen e ambientit** duke përfshirë këtu edhe **fushata vetëdijësimi** për menaxhimin e mbeturinave në zonat rurale.

Ne do të bëjmë edhe planifikimin e një buxheti të dedikuar për projekte zhvillimore, i cili do të mundësojë zbatimin e nismave konkrete dhe mbështetjen e fermerëve, duke përfshirë:

- **Subvencione për ndërtimin e serave dhe përkrahje për bletarinë**
- **Projekte edukative për teknikat moderne bujqësore**
- **Mbështetje për menaxhimin e mbeturinave bujqësore dhe shtëpiake në fshatra**

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në fazë konsolidimi, dhe ka nevojë për mbështetje të mëtejshme, për të realizuar misionin e saj.

Për t'u shndërruar në një faktor real, zhvillimi dhe bujqësor në komunën e Mitrovicës Veriore.